



BASHKIA KORÇË

# **BUXHETI VJETOR 2020**

## **DHJETOR 2019**



## BASHKIA KORÇË

Ka qytete që edhe emri u tingëllon në menyrë të magjishme. E tillë është Korça, qyteti i serenatave, qyteti i dashurisë, qyteti i artit, qyteti i birrës, Parisi i vogël, e po të kërkosh, gjen plot epitete të tjera që cilësojnë jo vetëm vlerat e saj, por dhe karakteristikat se përse duhet vizituar ky qytet i qeshur dhe plot jetë. Shpejtësia e urbanizimit dhe rivitalizimit është mbresëlënëse në këtë qytet. Rrugët me kalldrëme, shtëpitë karakteristike plot dritë, me histori të patreguara, kangjellat tipike ku kacavirren trëndafila e lule aromëmirë, me plot objekte të hershme kulturore historike dhe artistike, me festat e zhurmshme, karnavalet, ushqimin dhe krenarinë, e sidomos me mikepritjen.

Korça është një krahinë e Shqipërisë e gjitha për t'u vizituar, si nga ana kulturore, ashtu edhe për nga vlerat e saj natyrore që disponon me anë të monumenteve të shumta që natyra ia ka falur krahinave përreth saj. Korça si qytet dhe rrethi i saj shquhen për objektet dhe mjediset e veçanta me vlera të larta turistike. Korça u ofron turistëve një trashëgimi të pasur kulturore në arkitekturë, urbanistikë, monumente kulture etj. Ekoturizmi është një fushë me interes të veçantë për të apasionuarit e natyrës së bukur korçare. Ky është një qytet gazmor e magjik, që me serenatat e tij është bërë i njohur në të gjithë botën.

Për Korçën mund të flasësh gjatë, por për të zbuluar magjinë, embëlsinë, dinamizmin, ritmin e vërtetë të këtij qyteti, duhet patjetër ta vizitoni atë!






## BASHKIA KORÇË

### *Pozita Gjeografike:*

Bashkia e Korçës shtrihet në pjesën Juglindore të Shqipërisë, në Krahinën Malore Qendrore. Qyteti i Korçës është një nga qytetet kryesore të Shqipërisë. Shtrihet në pjesën Juglindore të vendit, në rrëzë të malit të Moravës, në lartësinë 869 metra mbi nivelin e detit. Relievi është kryesisht malor e kodrinor. Lartësia mesatare është 1145 metra. Korça, si rajon, është e rrethuar nga një numër i konsiderueshëm kodrash e malesh, në lindje qyteti kufizohet me malin e Moravës dhe në perëndim me zonën e Gorës, Voskopojës dhe Vithkuqit, të cilat janë zonat më malore. Në jug ndodhet Mali i Qarrit dhe në pjesën veriore është Mali i Thatë. Zona e ulët përfshin fushën e Korçës, një ndër më të mëdhatë e Shqipërisë dhe fushën e Devollit të Sipërm.

Zona e Korçës është e pasur me burime nënujore, lumenj, ku më i rëndësishmi është lumi i Devollit me degën Dunavec dhe Osumi i Sipërm. Në këtë zonë gjenden burimet e tre lumenjve të Shqipërisë (Devoll, Shkumbin dhe Osum). Liqenet janë Prespa e Madhe dhe Prespa e Vogël.

Korça kufizohet në veri me qytetin e Pogradecit i cili ndodhet 41 kilometra, në jug me qytetin e Ersekës, 45 kilometra, në lindje me Bilishtin, 27 kilometra, dhe në perëndim me Skraparin. Qyteti i Korçës ndodhet 181 kilometra larg kryeqytetit të vendit, Tiranës.





## BASHKIA KORÇË

### **Popullsia:**

Bashkia Korçë ka 130 531 banorë dhe një sipërfaqe prej 805.99 km<sup>2</sup>.

Bashkia Korçë përbëhet nga 8 njësi administrative: Korçë, Qendër Bulgarec, Voskop, Voskopojë, Lekas, Vithkuq, Mollaj dhe Drenovë.

Të gjitha njësitë administrative janë aktualisht pjesë e rrethit të Korçës dhe Qarkut Korçë.

Bashkia ka nën administrimin e saj 1 (një ) qytet dhe 62 (gjashtëdhjetë e dy) fshatra.

Qyteti ka një ekonomi të konsoliduar dhe biznese të shumta.

Zonat rurale, pjesë e bashkisë, merren kryesisht me bujqësi dhe blegtori, por pjesë e bashkisë janë edhe disa fshatra turistike. Në zonat rurale janë zhvilluar nga njëra anë bujqësia dhe pemëtaria, dhe nga ana tjetër turizmi malor ku banorët ofrojnë ambiente akomoduese dhe shërbimi por edhe aktiviteteve dimërore si një atraksion i shtuar për turistët.





## BASHKIA KORÇË

### Përmbajtja e buxhetit vjetor 2020

Hyrje.....	7
1.Kuadri ligjor .....	7
2. Parime të autonomisë fiskale.....	7
3. Objektivat kryesore për buxhetin vendor të vitit 2020.....	10
4. Të ardhurat e veta të Njërive të Vetëqeverisjes Vendore.....	11
4.1 Të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore .....	11
Tabela e të ardhurave të institucioneve për vitin 2020.....	45
5. Transferta nga buxheti i shtetit.....	46
5.1. Transfera të pakushtëzuara 2020.....	46
5.2. Transferat e pakushtëzuara sektoriale.....	47
5.3. Transfera të kushtëzuara.....	48
5.4. Fondi për Zhvillimin e Rajoneve.....	49
6. Buxheti 2020 .....	50
6.1. Dokumentacioni bazë .....	52
6.2. Dokumentacioni shoqërues .....	56
7. Detajimi i buxhetit të Bashkisë sipas programeve .....	60
Organet ekzekutive dhe legjislative për çështjet financiare dhe fiskale, çështjet e brendshme 01160	
7.1. Programi: Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi 01110 .....	60
7.2. Programi: Çështjet financiare dhe fiskale 01120.....	65
7.3. Programi: Pagesa për shërbimin e borxhit të brendshëm 01710 .....	66
7.4. Programi:Shërbimet e policisë vendore 03140.....	68
7.5. Programi: Mbrojtja nga Zjarri dhe Mbrojtja Civile 03280.....	70
7.6. Programi: Mbështetja për Zhvillimin Ekonomik 04130.....	73
7.7. Programi: Shërbimet bujqësore, inspektimi, siguria ushqimore dhe mbrojtja e konsumatorëve 04220.....	74
7.8. Programi: Administrimi i pyjeve dhe kullotave 04260 .....	75
7.9. Programi: Rrjeti rrugor rural 04520.....	77
7.10. Programi: Transporti publik 04570.....	77
7.11. Programi: Zhvillimi i turizmit 04760.....	80
7.12. Fondi rezervë 04910.....	114
7.13. Fondi i kontigjencës 04940 .....	114
7.14. Programi: Menaxhimi i mbetjeve 05100 .....	114
7.15. Programi: Ndërgjegjësimi mjedisor 05630.....	116



## BASHKIA KORÇË

7.16.	Programi: Planifikimi urban vendor 06140 .....	118
7.17.	Programi: Shërbime publike vendore 06260 .....	119
7.18.	Programi: Sport dhe argëtim 08130 .....	120
7.19.	Programi: Arsimi bazë dhe parashkollor 09120 .....	125
7.20.	Programi: Arsimi I mesëm I përgjithshëm 09230.....	126
7.21.	Programi: Sigurimi shoqëror 10220.....	129
7.22.	Programi: Kujdesi social për personat e sëmurë dhe me aftësi të kufizuara 10140.....	133
7.23.	Programi: Kujdesi social për familjet dhe fëmijët 10430 .....	137
7.24.	Programi: Strehimi social 10661.....	143
8.	Buxheti 2020 për institucionet e varësisë.....	149
8.1.	Ndërmarrja e Shërbimeve Publike .....	149
8.1.1.	Programi: Menaxhimi i Infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit 04240.....	149
8.1.2.	Programi: Rrjeti rrugor rural 04520 .....	150
8.1.3.	Programi: Shërbime publike vendore 06260 .....	151
8.1.4.	Programi: Ndriçim rrugësh 06440 .....	156
8.2.	Klubi Shumësportësh .....	158
8.2.1.	Programi: Sport dhe argëtim 08130 .....	158
8.3.	Qendra e Artit dhe Kulturës .....	162
8.3.1.	Programi: Trashëgimia kulturore, eventet artistike dhe kulturore 08220 .....	162
8.4.	Ndërmarrja e Shërbimeve Mbështetëse e Arsimit dhe Çerdhes.....	167
8.4.1.	Programi: Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor 09120 .....	167
8.4.2.	Programi: Arsimi i mesëm i përgjithshëm 09230 .....	170
8.4.3.	Programi: Arsimi profesional 09230.....	173
8.4.4.	Programi: Kujdesi social për familjet dhe fëmijët 10430 .....	175
8.5.	Qendra Ditore dhe Qendra Rezidenciale e Zhvillimit.....	179
8.5.1.	Programi:Kujdesi social për personat e sëmurë dhe me aftësi të kufizuara 10140.....	179
8.6.	Shtëpia e Foshnjës .....	181
8.6.1.	Programi: Kujdesi social për familjet dhe fëmijët 10430 .....	181
8.7.	Njësia e Menxhimit të Banesave me Qëllim Social .....	182
8.7.1.	Programi: Strehimi social 10661.....	182
9.	Të tjera .....	184



## BASHKIA KORÇË

### **Hyrje**

Buxheti 2020 dhe PBA 2020-2022 bazohen tek ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, si dhe ligji nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”. Ky buxhet bazohet në një kuadër makroekonomik të kujdesshëm dhe realist. Bashkia harton, miraton, zbaton dhe administron çdo vit buxhetin e vet, të pavarur, i cili krijohet në mënyrën e parashikuar me ligj, pa defiçit, si dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi, që rregullon administrimin dhe zbatimin e sistemit buxhetor dhe ligjin për financat vendore.

Buxheti 2020 vijon të mbështesë reformat e ndërmarra që promovojnë rritjen ekonomike, punësimin si dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimeve ndaj qytetarëve.

### **1. Kuadri ligjor**

- Ligji nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”;
- Ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”;
- Ligji nr. 9632/2006 “Për sistemin e taksave vendore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar
- Ligji nr. 9936/2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 10296/2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 9869/2008 “Për huamarrjen e qeverisjes vendore”;
- Udhëzimi i MF nr. 23 datë 30.7.2018 “Për procedurat standarte për përgatitjen e PBA-së”, të NJQV;
- Udhëzimi nr. 2 datë 06.02.2012 i Ministrisë së Financave “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”;i ndryshuar
- Ligje dhe akte nënligjore të tjera.

### **2. Parime të autonomisë fiskale**

1. Njësive të vetëqeverisjes vendore u garantohet e drejta për krijimin e të ardhurave në mënyrë të pavarur, në përputhje me ligjet dhe aktet e tjera ligjore në fuqi.



## BASHKIA KORÇË

2. Njësive të vetëqeverisjes vendore u garantohet e drejta për të përfituar transfertë të pakushtëzuar nga Buxheti i Shtetit, e cila ndahet sipas kriterëve të përcaktuara në ligj.
3. Njësive të vetëqeverisjes vendore u garantohet e drejta për të përfituar nga ndarja e të ardhurave nga taksat kombëtare dhe tatimet, të cilat ndahen sipas kriterëve të përcaktuara në ligj.
4. Njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë autonomi të plotë në përdorimin e të ardhurave të veta, të transfertës së pakushtëzuar dhe të ardhurave nga taksat e ndara.
5. Propozimet e qeverisjes qendrore për ndryshime në legjislacion, me efekt pakësimin e nivelit dhe/ose të llojeve të të ardhurave vendore dhe/ose transferimin e funksioneve ose kompetencave në nivel vendor, konsultohen paraprakisht me njësitë e vetëqeverisjes vendore.
6. Në rastet kur ulen apo hiqen taksa ose tarifa vendore nga qeverisja qendrore, njësitë e vetëqeverisjes vendore kompensohen plotësisht, nëpërmjet rritjes së transfertës së pakushtëzuar, taksave të ndara, transferimit në nivel vendor të një takse tjetër kombëtare ose kombinimi i tyre.
7. Funksionet ose kompetencat që u transferohen apo delegohen njësive të vetëqeverisjes vendore, si dhe vendosja e një standardi të ri kombëtar për kryerjen e funksioneve ose kompetencave, shoqërohen kurdoherë me mjetet dhe burimet e nevojshme financiare për ushtrimin e tyre.

Thellimi i decentralizmit fiskal, rritja e autonomisë financiare dhe konsolidimi i financave vendore janë ndër objektivat kryesore të qeverisë në drejtim të përdorimit me efektivitet të fondeve publike në nivel vendor dhe përmirësimit të standarteve të shërbimeve që i ofrohen komunitetit nga njësitë e vetëqeverisjes vendore. Viti 2020, do të jetë viti i zbatimit të plotë të të gjithë instrumenteve të reja financiare të parashikuara në ligjin për financat e vetëqeverisjes vendore (68/2017), me synimin e konsolidimit të burimeve të financimit, për të garantuar një menaxhim më cilësor të shpenzimeve vendore.

Rritja e burimeve të buxhetit vendor në vitin 2020, krijon më shumë hapësira për përmirësimin e cilësisë së shërbimeve për qytetaret (për funksionet ekzistuese dhe ato të reja të tranferuara me reformën administrativo territoriale).



## BASHKIA KORÇË

Fokusi kryesor në buxhetin vendor të vitit 2020, për Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë do të jetë konsolidimi i procesit të menaxhimit financiar në nivel vendor në funksion të vazhdimit të zbatimit të reformës administrative territoriale dhe decentralizimit fiskal të njësive të vetëqeverisjes vendore nëpërmjet:

- Forcimit të disiplinës financiare në nivel vendor, nëpërmjet vendosjes së parimeve, rregullave, proceseve dhe procedurave për hartimin, zbatimin dhe kontrollin e buxhetit, duke synuar parandalimin e krijimit të detyrimeve të prapambetura (të papaguara).
- Planifikim dhe buxhetim eficient dhe i mirë-integruar i shpenzimeve publike në nivel vendor me synim rritjen e efektivitetit dhe përdorimit me ekonomi të fondeve publike.
- Përmirësimi i raporteve të monitorimit, duke u fokusuar tek standartizimi i formateve raportuese, përdorimi i treguesve të performancës për çdo program buxhetor si dhe përmirësimi i aftësive monitoruese dhe të raportimit për të identifikuar në kohë probleme potenciale gjatë zbatimit të buxhetit.
- Përmirësimi i metodologjisë për analizën, ndjekjen dhe monitorimin e performancës buxhetore të njësive të vetëqeverisjes vendore. Nëpërmjet kësaj metodologjie do të synohet që përmes treguesve të performancës të matet efektiviteti i përdorimit të fondeve publike në nivel vendor.
- Forcimi i planifikimit strategjik dhe procesit të menaxhimit të buxhetit vendor.
- Menaxhimi efektiv i të ardhurave vendore si një mënyrë e rëndësishme për të rritur investimet dhe rialokimin e fondeve në interesin publik;
- Përcaktimi i rregullave për menaxhimin e situatave të vështirësive financiare si një formë e rëndësishme e vlerësimit të njësive të vetëqeverisjes vendore; Implementimi i një metodologjie të mirëstrukturuar në lidhje me evidentimin e rasteve të vështirësive financiare të njësive të vetëqeverisjes vendore.
- Përmirësimi i raportimit dhe analizave për financat vendore si nga vetë njësitë në nivel vendor por gjithashtu edhe nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë.
- Rritja e parashikueshmërisë, efektivitetit dhe transparencës së transfertave ndërqeveritare si një formë e rëndësishme e konsolidimit fiskal;



## BASHKIA KORÇË

Gjithashtu, përmes buxhetit të vitit 2020, do të vazhdojë mbështetja financiare për reformën në arsimin parashkollor me synim vendosjen e një skeme financimi të përshtatshme dhe efektive që synon përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimeve. Në buxhetin e vitit 2020, fondet e pagave për edukatorët do të ndahen kryesisht mbi bazën e numrit të fëmijëve. Më specifiku, 60% e fondeve për pagat e edukatoreve do të ndahen mbi bazën e numrit të fëmijëve (me moshë 3-6 vjeç) dhe 40% mbi bazën e numrit të edukatoreve.

Reforma për financimin e funksionit të arsimit parashkollor do të vazhdojë të sigurojë:

- Uljen e madhësisë së grupeve/klasave të fëmijëve në kopshte nga raporti aktual mesatar 18 fëmijë për një edukatore në raportin 15 fëmijë për një edukatore.
- Ruajtjen e nivelit aktual të fondeve për ato bashki të cilat rezultojnë të kenë një numër relativisht "të lartë" edukatoresh për numrin e fëmijëve të regjistruar në kopshte, krahasimisht me bashkitë e tjera.
- Një ndarje më të drejtë të fondeve për pagat e edukatoreve, duke zbutur diferencat ndërmjet bashkive përsa i përket raportit fëmijë për edukatore.

### 3. Objektivat kryesore për buxhetin vendor të vitit 2020

- **Ngritja e kadastrës fiskale** dhe implementimit në të gjitha njësitë e vetëqeverisjes vendore me qëllim taksimin sa më të drejtë, me objektiv rritjen e të ardhurave për njësitë e vetëqeverisjes vendore;
- **Harmonizimi dhe unifikimi i procedurave mbi hartimin, zbatimin, raportimin, monitorimin e buxheteve** të njësive të vetëqeverisjes vendore, konform standarteve ndërkombëtare;
- **Konsolidimi i procedurave dhe i sistemit të menaxhimit të financave vendore** në të gjithë etapat, që nga hartimi i programit buxhetor afatmesëm tek zbatimi dhe monitorimi i tij;



## BASHKIA KORÇË

- **Menaxhimi më i mirë i shpenzimeve administrative** me qëllim ofrimin e më shumë shërbimeve publike cilësore me një kosto sa më të ulët. Kjo, do të arrihet nëpërmjet rritjes së peshës së shpenzimeve për investime dhe uljes së peshës që zënë shpenzimet administrative;
- **Rritja e eficiencës në ofrimin e shërbimeve publike** në nivel vendor, duke identifikuar tregues të performancës së shërbimit të ofruar;
- **Përmirësimi i cilësisë së raporteve të monitorimit** të buxhetit vendor dhe krijimi i një sistemi të monitorimit mbi bazën e treguesve të performancës.
- **Sigurimi i menaxhimit financiar transparent dhe efektiv** për të gjitha njësitë e vetëqeverisjes vendore;
- **Rritja e transparencës dhe llogaridhënies** së qeverisjes vendore në raport me komunitetin, në drejtim të monitorimit të publikimit të dokumentave buxhetorë dhe zhvillimin të seancave të vazhdueshme të konsultimit me qytetarët.
- **Implementimi i një metodologjie** të mirëstrukturuar në lidhje me evidentimin e rasteve të vështirësive financiare të njësisë të vetëqeverisjes vendore.

### **4. Të ardhurat e veta të Njësisë të Vetëqeverisjes Vendore**

Njësitë e vetëqeverisjes vendore financohen nga të ardhurat që sigurohen nga taksat, tarifat dhe të ardhurat e tjera vendore, nga fondet e transferuara nga Buxheti i Shtetit dhe fondet që u vijnë drejtpërdrejt nga ndarja e taksave e tatimeve kombëtare, huamarrja vendore, donacionet, si dhe burime të tjera të parashikuara në ligj.

#### **4.1 Të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore**

1. Njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë të drejtë të administrojnë taksat vendore, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi.
2. Taksat vendore mund të klasifikohen sipas kategorive të mëposhtme:
  - a) taksa mbi pasurinë e paluajtshme, në të cilën përfshihen taksa mbi ndërtesat, taksa mbi tokën bujqësore dhe taksa mbi truallin, si dhe mbi transaksionet e kryera me to;
  - b) taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja;
  - c) taksa vendore mbi veprimtarinë e shërbimit hotelier;



## BASHKIA KORÇË

- d) taksa e tabelës;
- e) taksa vendore të përkohshme, të cilat vendosen sipas mënyrës së parashikuar në ligj;
- f) taksa vendore mbi veprimtarinë ekonomike të biznesit të vogël;
- g) taksa vendore mbi të ardhurat vetjake, taksa mbi të ardhurat e krijuara nga dhuratat, trashëgimitë, testamentet ose lotaritë vendore;
- h) taksa të tjera, të përcaktuara me ligj.

Planifikimi i të ardhurave i vitit 2020 për Bashkinë Korçë mbështetet kryesisht në politikat e përcaktuara për periudhën në vijim duke u mbështetur në aktet ligjore për to, llogaritjet e kapacitetit të taksave dhe tarifave, informacionin e përfituar nga programi i taksave dhe tarifave vendore si dhe në ecurinë e realizimit të tyre në vite. Planifikimi i vitit 2020 mbështetet në llogaritjet e përgjithshme për realizimin e parashikimeve të të ardhurave. Planifikimi i të ardhurave për vitin 2020 reflekton ndryshimet në paketën fiskale aktuale por dhe paketat fiskale të viteve të mëparshme si dhe parashikon rritjen e nivelit të të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore duke forcuar kapacitetet administruese dhe duke zgjeruar numrin e bazës së taksapaguesve.

Në këtë planifikim janë marrë në konsideratë:

- Rritja e të ardhurave nëpërmjet zgjerimit të bazës së taksapaguesve dhe luftës kundër evazionit fiskal (evidentimi, zbatimi rigoroz i masave shtrënguese, monitorimi i subjekteve mospaguese dhe atyre të reja).
- Lehtësimi i procedurave në marrëdhënie me subjektet dhe familjarët.
- Ecuria e realizimit të të ardhurave dhe analiza një për një e çdo takse dhe tarife, për faktorët që kanë ndikuar në rritjen ose pakësimin e arkëtimeve.

Mbështetur në legjislacion dhe në vendimet e Këshillit të Bashkisë, për mbledhjen e të ardhurave janë përcaktuar edhe strukturat përkatëse, si më poshtë:

- Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore
- Drejtoria e Financës
- Drejtoria Juridike
- Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit
- Drejtoria e Kontrollit të Territorit
- Agjentët tatimorë të përcaktuar sipas ligjit dhe vendimeve të Këshillit të Bashkisë



## BASHKIA KORÇË

Drejtoritë e Bashkisë janë strukturat kryesore, për mbledhjen dhe rakordimin e të gjitha të ardhurave të Bashkisë Korçë, të cilat jo vetëm arkëtojnë por dhe monitorojnë të gjitha strukturat e tjera.

Në mënyrë të detajuar realizimi i vitit 2018, planifikimi i vitit 2019, realizimi 10 - mujor i vitit 2019, plani I realizimit të pritshëm i vitit 2019 dhe planifikimi për vitin 2020 në lidhje me taksat dhe tarifatat vendore në Bashkinë e Korçës, paraqitet si më poshtë:

Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Realizim 2018	Plani 2019	Realiz.10 muaj '19	/lekë	
					Pl I real të pritshtëm 2019	Plani 2020
1	Taksë mbi ndërtesën	102,952,983	149,569,021	82,281,759	113,003,491	151,118,200
2	Taksë mbi truallin	9,127,377	9,000,000	7,306,419	9,015,889	13,020,875
3	Taksë mbi tokën bujqësore	22,657,362	48,672,040	11,838,638	23,550,795	54,066,337
4	Tatim shitjeje pasuri e paluajtshme	9,590,732	13,000,000	8,296,582	10,000,000	11,000,000
5	Taksë rregjistrimi e përvitshme (automjete)	37,623,253	42,000,000	29,352,323	40,000,000	40,000,000
6	Tatim fitimi i thjeshtuar për biznesin e vogël	5,190,961	23,000,000	4,676,341	5,000,066	6,000,000
7	Taksë për ndërtimet e reja	59,464,396	240,000,000	60,502,620	76,719,269	174,650,000
8	Taksë ndikimi në infrastrukturë nga legalizimet	26,006,146	40,000,000	12,711,105	15,647,234	30,000,000
9	Taksë fjetje në hotel	5,059,780	5,500,000	4,654,400	5,603,910	6,000,000
10	Taksë table	9,551,861	15,903,439	7,299,622	9,002,673	10,000,000
11	Dividenti nga UKKO	7,864,515	9,000,000	15,515,582	15,515,582	9,000,000
12	Dividenti nga Tregu i Shumicës	0	1,600,000	0	1,000,000	1,000,000
13	Renta minerare	110,375	200,000	25,540	207,229	350,000
14	Tarifë regjistrimi për leje transporti	1,065,480	2,600,000	1,190,900	1,300,000	1,000,000
15	Tarifë therje bagëti	2,397,550	3,000,000	1,861,350	2,683,850	4,000,000
16	Tarifë mur perimetral	628,832	1,500,000	721,100	947,140	800,000
17	Tarifë pastrimi	155,983,218	183,509,590	140,444,420	168,000,000	191,267,500
18	Tarifë ndriçimi	37,942,813	44,423,704	31,563,361	38,072,500	44,588,400
19	Tarifë gjelbërimi	24,707,001	31,716,687	21,259,162	24,199,999	27,993,050
20	Tarifë mirëmbajtje varreza publike	14,273,419	18,834,554	10,597,945	13,499,903	17,031,850
21	Tarifë zënie hapësire publike	15,048,221	30,388,546	17,290,958	22,000,000	28,232,500


**BASHKIA KORÇË**

22	Tarifë parkimi	20,666,333	22,900,000	14,589,386	19,000,223	22,500,000
23	Tarifë shërbimi, vërtetime, çertifikata, regj.biz+linjat ajrore + gjobe kolaud mat.drusore+ T. Tavolina+uji	7,626,816	36,697,775	10,010,563	12,504,311	15,406,530
24	Çertifikatë për mbrojtjen nga zjarri	498,400	500,000	70,700	100,000	130,000
25	Miratim projekti	119,000	300,000	421,400	300,000	220,000
26	Shërbime zjarrfikse në objekte të sig.	0	30,000	0	0	50,000
27	Marrje me qera pylli+ qera per kullota	13,872,624	13,000,000	11,042,674	13,000,000	9,000,000
28	Të ardhura nga shitja e druve të zjarrit	3,755,676	16,330,820	9,240,960	10,000,000	3,000,000
29	Vërtetime transporti	108,000	50,000	63,000	50,000	40,000
30	Prodhimet e dyta medicinale	289,250	400,000	663,000	400,000	600,000
31	Shitje Dokumenta ankandi	1,000	2,000	2,000	2,000	2,000
32	Gjoha policia bashkiake	2,557,000	2,500,000	1,286,000	1,500,000	1,700,000
33	Gjoha për vonesë në pagesë	7,466,884	7,000,000	4,417,586	6,120,965	5,000,000
34	Gjoha inspektoriat i ndërtimit	2,160,000	2,500,000	1,196,000	2,000,000	2,000,000
35	Gjoha të drejtorisë së kontrollit të territorit	341,500	660,000	260,500	450,000	400,000
36	Gjoha të D.T.T.V	60,000	300,000	120,000	300,000	100,000
37	Qira objekti,Qera Trualli,Qera T.bujqësore	1,908,587	8,625,210	4,677,376	6,000,351	8,700,919
38	Tarifë vendore për shqyrtim leje zhvillimi	440,000	760,000	440,000	500,000	440,000
39	Tarife për leje ndërtimi	123,000	500,000	171,000	160,300	140,000
40	Tarifë servituti	486,544	1,000,000	479,076	900,000	1,000,000
41	Të ardhura nga qiratë, banesa sociale	6,929,215	7,080,000	5,965,786	7,080,000	7,080,000
42	Qira nga banesat në pronësi të Bashkisë Korçë,Enti Kombëtar i Banesave	3,243,939	3,585,200	2,519,869	3,585,200	3,300,000
43	Kamatë vonesa(qira objekti)	417,314	500,000	352,258	500,000	500,000
44	Tarifë për dhënie në përdorim të tubacioneve nëntokësore	5,040	3,000	0	3,000	589,947

**BASHKIA KORÇË**

45	Tarifë për depozitim e mbetjeve inerte					3,500,000
46	Tarifë për ujitjen dhe mirëmbajtje të kanaleve					18,420,000
	<b>TOTALI</b>	<b>620,322,397</b>	<b>1,038,641,586</b>	<b>537,379,261</b>	<b>679,425,881</b>	<b>924,938,108</b>

	REALIZIM		PLANIFIKIM
	2018	2019 (i pritshëm)	2020
<b>Të ardhura ndër vite</b>	<b>620,322,397</b>	<b>679,425,881</b>	<b>924,938,108</b>

**1. TAKSA MBI NDËRTESESËN**

Lloji i taksës	REALIZIM		PLANIFIKIM
	2018	2019 (i pritshëm)	2020
<b>Taksë mbi ndërtesën</b>	<b>102,952,983</b>	<b>113,003,491</b>	<b>151,118,200</b>

Taksa mbi ndërtesën për vitin 2020 planifikohet të jetë në vlerën 151,118,200 lekë.

Kjo taksë planifikohet të arkëtohet në vlerën 53,601,663 lekë prej 3,607 ndërtesash që shfrytëzohen nga subjektet e biznesit të vogël, subjektet e biznesit të madh, O.J.F apo njësi në pronësi të individëve të destinuar për veprimtari social-ekonomike të cilët nuk i kanë vënë në shfrytëzim në Bashkinë Korçë me një sipërfaqe prej 580,556.90 m<sup>2</sup>.



## BASHKIA KORÇË

Në njësinë administrative Korçë sipërfaqja prej 416,829.17 m<sup>2</sup> detajohet si më poshtë:

- 248,337.35 m<sup>2</sup> sipërfaqe për tregëti dhe shërbime,
- 61,198.05 m<sup>2</sup> sipërfaqe për prodhim,
- 116,027.39 m<sup>2</sup> sipërfaqe për magazina, bodrume, parkinge të mbuluara dhe ndërtesa të tjera

Në njësitë e tjera administrative të Bashkisë Korçë sipërfaqja prej 154,994.11 m<sup>2</sup> detajohet si më poshtë:


- 86,295.01 m<sup>2</sup> sipërfaqe për tregëti dhe shërbime,
- 57,022.90 m<sup>2</sup> sipërfaqe për prodhim
- 5,110.20 m<sup>2</sup> sipërfaqe për blegtori
- 6,566 m<sup>2</sup> sipërfaqe për magazina, bodrume dhe ndërtesa të tjera.

Nga familjarët e Bashkisë Korçë planifikohet të arkëtohet në vlerën 60,355,926 lekë prej 17,047 njësi pronësore që taksohen për banim me sipërfaqe 2,111,820 m<sup>2</sup> në njësinë administrative Korçë dhe 8,902 njësi pronësore që taksohen për banim me sipërfaqe 810,490 m<sup>2</sup> në njësitë e tjera administrative të Bashkisë Korçë si dhe nga debitorët familjarë në vlerën 12,856,665 lekë dhe debitorët e subjekteve të biznesit parashikohet të arkëtohet në vlerën 24,303,948 lekë.

Theksojmë këtu se ndikim negativ në këtë planifikim kanë pasur lehtësitë fiskale të ndërmara nga Bashkia Korçë. Vetëm për vitin 2019 janë të përjashtuar 4,591 familje me njësi pronësore për banim me sipërfaqe totale 590,590.21 m<sup>2</sup>, konkretisht në njësinë administrative Korçë 3,349 familje me njësi pronësore me sipërfaqe totale për banim 442,824.14 m<sup>2</sup> dhe 1,242 familje me njësi pronësore me sipërfaqe totale për banim 147,766.07 m<sup>2</sup> në njësitë e tjera administrative me vlerë totale prej 12,327,606 lekë.

Strukturat përgjegjëse për arkëtimin e kësaj takse janë Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit, Njësitë Administrative të Bashkisë Korçë dhe agjenti tatimor U.K.KO. Sha.

Më poshtë po paraqesim grafikisht realizimin për vitin 2018, 2019 (i pritshëm) dhe planifikimin 2020 :





## BASHKIA KORÇË

### 2. TAKSA MBI TRUALLIN


Lloji i taksës	REALIZIM		PLANIFIKIM
	2018	2019 (i pritshëm)	2020
Taksë Trualli	9,127,377	9,015,889	13,020,875

Taksa mbi truallin për vitin 2020 planifikohet të jetë në vlerën 13,020,875 lekë. Ky planifikim vjen në këtë vlerë si rezultat i regjistrimeve dhe verifikimeve të kryera ndër vite duke pasur si vit fillestar vitin 2016 nga i cili filloi të aplikohet taksa mbi truallin. Kjo taksë paguhet si nga subjektet e biznesit të cilat disponojnë këtë pasuri për efekt të zhvillimit të aktivitetit të tyre apo dhe nga poseduesit familjarë. Nga të dhënat krahasimore që disponojmë deri më sot të kemi një ndryshim në rritje të regjistrimeve nga informacioni bazë si për numrin e poseduesve të truallit që e përdorin për biznes apo dhe atyre poseduesve familjarë që e përdorin truallin për banim ashtu dhe për sipërfaqet respektive të tyre. Taksa mbi truallin planifikohet të arkëtohet nga 392 subjekte të biznesit të vogël, biznesit të madh dhe personave të cilët kanë në pronësi truall të destinuar për aktivitet social-ekonomik me një sipërfaqe prej 508,078.3 m<sup>2</sup> të inventarizuara deri më tani në vlerën 8,654,477.4 lekë, nga 7,489 familje të Bashkisë Korçë me një sipërfaqe trualli për banim prej 1,023,211 m<sup>2</sup> të inventarizuara deri më tani në vlerën 429,748.62 lekë si dhe nga debitorët familjarë dhe debitorët e subjekteve të biznesit të cilët parashikohen të arkëtohen gjatë vitit 2020 në vlerën 3,936,649.18 lekë. Strukturat përgjegjëse për arkëtimin e kësaj takse, Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit, Njësitë Administrative të Bashkisë Korçë dhe agjenti tatimor U.K.KO Sha.

Më poshtë po paraqesim grafikisht realizimin për vitin 2018, 2019 (i pritshëm) dhe planifikimin 2020 :



## BASHKIA KORÇË



### 3. TAKSA MBI TOKËN BUJQËSORE

Lloji i taksës	REALIZIM		PLANIFIKIM
	2018	2019 (i pritshëm)	2020
Taksa mbi tokën bujqësore	22,657,362	23,550,795	54,066,337

Taksa mbi tokën bujqësore për vitin 2020 është planifikuar 54,066,337 lekë prej 11,323 pronarësh apo poseduesish të saj me një sipërfaqe prej 12,217.14 ha, konkretisht:

Nr	Njësia administrative	Nr / prona	Sip / hektar	Vlera / lekë
1	Njësia administrative Korçë	982	369.30	722,925
2	Njësia administrative Bulgarec	2994	3745.16	7,490,328.40
3	Njësia administrative Drenovë	2522	2035.76	4,372,455
4	Njësia administrative Mollaj	1351	1810.70	4,164,615.26
5	Njësia administrative Vithkuq	1043	1250.89	1,962,260.44
6	Njësia administrative Voskop	1309	2063.41	4,175,357.92
7	Njësia administrative Voskopojë	599	695.92	974,297
8	Njësia administrative Lekas	523	246	344,400

Gjithashtu në planifikimin për vitin 2020 një ndikim të ndjeshëm kanë dhe debitorët vlera e të cilëve përlllogaritet në masën 29,859,698 lekë, debi kjo e përlllogaritur për pronarët apo poseduesit e tokës bujqësore të cilët nuk e kanë paguar këtë taksë për vitin 2019 dhe ato më përpara. Gjithashtu po vazhdon puna në terren për evidentim e saktë të debitorëve pasi një pjesë e madhe e personave që i kanë marrë këto toka në përdorim sipas ligjit rezultojnë të mos jetojnë në Bashkinë Korçë por të jenë transferuar në qytete të tjera apo dhe jashtë vendit, kapacitet ky që ndikon ndjeshëm në rritjen e




## BASHKIA KORÇË

borxhit për këtë taksë. Problem rezulton dhe transferimi i familjeve nga njëra njësi në një njësi tjetër të Bashkisë Korçë pa kryer asnjë procedurë pranë zyrave të gjendjes civile. Ndryshimi i destinacionit të përdorimit është një fenomen tjetër që po na pengon pasi në shumë sipërfaqe të cilat ne i disponojmë si kapacitet toke bujqësore janë bërë ndërtime dhe sipërfaqja e tokës bujqësore ka humbur funksionalitetin prodhues duke u tjetërsuar në truall. Një problem tjetër është dhe inventarizimi i numrit të pronarëve apo poseiduesve të tokës bujqësore si dhe sipërfaqeve faktike të tokës bujqësore që ata disponojnë pasi informacioni i transferuar pranë Bashkive mbas reformës territoriale me gjendjen faktike ka shumë ndryshime si në sipërfaqet aktuale të tokës bujqësore ashtu dhe në ndryshimet e emrave apo mbiemrave të pronarëve apo poseiduesve të cilët janë pajisur me A.M.T.P nga ish komunat por që këto ndryshime nuk janë pasqyruar në asnjë regjistër që dispononin ish komunat.

Strukturat përgjegjëse për arkëtimin e kësaj takse, po vijojnë punën intensivisht në bashkëpunim të ngushtë dhe me Agjensinë Shtetërore të Kadastrës për konsolidimin e bazës së të dhënave për taksapaguesit dhe saktësimin e sipërfaqeve.

**Më poshtë po paraqesim grafikisht realizimin për vitin 2018, 2019 (i pritshëm) dhe planifikimin 2020 :**



#### **4. TAKSA MBI KALIMIN E SË DREJTËS SË PRONËSISË PËR PASURITË E PALUAJTSHME**

Lloji i taksës	REALIZIM		PLANIFIKIM
	2018	2019 (i pritshëm)	2020
Taksa mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme	9,590,732	10,000,000	11,000,000


Taksa mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme paguhet para kryerjes së regjistrimit nga personi që kalon të drejtën e pronësisë mbi pasurinë e paluajtshme, dhe vendoset për të gjitha pasuritë nga Agjensia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Korçë. Planifikimi për



## BASHKIA KORÇË

vitin 2020 do të jetë 11,000,000 lekë, duke ju referuar parashikimit të bërë nga Agjensia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Korçë me shkresën Nr.6976/1 prot, datë 29.10.2019, e cila në rolin e agjentit tatimor e mbledh këtë taksë dhe e transferon për llogari të pushtetit vendor.

Më poshtë po paraqesim grafikisht realizimin për vitin 2018, 2019 (i pritshëm) dhe planifikimin 2020 :



### 5. TAKSA E REGJISTRIMIT TË PËRVITSHËM TË MJETEVE TË TRANSPORTIT RRUGOR


Lloji i taksës	REALIZIM		PLANIFIKIM
	2018	2019 (i pritshëm)	2020
Taksa e regjistrimit të përvitshëm të mjeteve të transportit rrugor	37,623,253	40,000,000	40,000,000

Taksa e regjistrimit të përvitshëm të mjeteve të transportit rrugor për vitin 2020 është planifikuar 40,000,000 lekë parashikim ky i bërë nga D.R.SH.T.R-Korçë me shkresën Nr.8012/1 prot, datë 15.10.2019 e cila referuar pikës 3, të Nenit 4 të Ligjit 9975, në rolin e agjentit tatimor, arkëton detyrimin nga pronari i mjetit për vlerën e taksës për automjetin, para kryerjes së kontrollit teknik vjetor të detyrueshëm të mjetit dhe e transferon për llogari të pushtetit vendor. Ky parashikim është bërë nga D.R.SH.T.R-Korçë bazuar në realizimin e viteve paraardhëse, ndryshimet e fundit ligjore si dhe në të dhënat e disponuara për periudhën Janar – Shtator të vitit 2019.

Më poshtë po paraqesim grafikisht realizimin për vitin 2018, 2019 (i pritshëm) dhe planifikimin 2020 :



BASHKIA KORÇË




**6. TATIMI FITIMI I THJESHTUAR PËR BIZNESIN E VOGËL**

Lloji i taksës	REALIZIM		PLANIFIKIM
	2018	2019 (i pritshëm)	2020
<b>Tatim fitimi i thjeshtuar për biznesin e vogël</b>	<b>5,190,961</b>	<b>5,000,066</b>	<b>6,000,000</b>

Çdo subjekt, i cili kryen një biznes, me anë të të cilit realizohet gjatë vitit fiskal qarkullim më i vogël ose i barabartë me 8,000,000 (tetë milionë) lekë, i nënshtrohet detyrimit të pagesës së tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël. Shkalla tatimore e aplikueshme mbi fitimin e tatueshëm, subjekt i tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël, me qarkullim vjetor nga 5 deri në 8 milionë, është 5% dhe për subjektet me qarkullim vjetor nga 0 deri në 5 milionë lekë, është 0 lekë në vit. Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël për vitin 2020 parashikohet të jetë 6,000,000 lekë, parashikim ky i bërë nga Drejtoria Rajonale Tatimore Korçë. Siç e kemi theksuar ndër vite është një ndër taksat që është prekur ndjeshëm dhe shpesh nga ndryshimet në legjislacionin tatimor. Drejtoria Rajonale Tatimore Korçë, është e ngarkuar me vlerësimin, mbledhjen, kontrollin, arkëtimin dhe transferimin në llogaritë e buxhetit të qeverisjes vendore të të ardhurave nga tatimi i thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël. Administrata Tatimore Qendrore transferon të ardhurat nga tatimi i thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël në llogari të bashkive, ku ka vendndodhjen biznesi i taksueshëm, brenda datës 10 të muajit pasardhës, kur janë arkëtuar tatimet. Administrata Tatimore Qendrore, për shërbimin që kryen, merr një komision. Ky komision llogaritet në përqindje të shumës së tatimit që kanë arkëtuar dhe kanë transferuar në buxhetin e njësisë të qeverisjes vendore, i cili është në masën 1 për qind dhe derdhet në llogari të Administratës Tatimore Qendrore. Ky tatim planifikohet të realizohet në këtë vlerë nga subjektet që i nënshtrohen pagesës së tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël, nga subjektet debitore të cilët nuk do e paguajnë tatimin e thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël deri në fund të vitit 2019.



## BASHKIA KORÇË




### 7. TAKSA E NDIKIMIT NË INFRASTRUKTURË NGA NDËRTIMET E REJA

Lloji i taksës	REALIZIM		PLANIFIKIM
	2018	2019 (i pritshëm)	2020
<b>Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja</b>	<b>59,464,396</b>	<b>76,919,269</b>	<b>174,650,000</b>

Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja për vitin 2020 planifikohet në vlerën 174,650,000 lekë parashikim ky i bërë nga Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit. Në lidhje me parashikimin e kësaj takse i jemi referuar ndryshimeve në paketën fiskale të vitit 2020. Gjithashtu ndikim do të ketë dhe efekti i ndërtimeve (meremetime, rikonstruksione dhe rindërtime) për të zhdukur dëmet e shkaktuara nga tërmetet e shpeshta të gjysmës së dytë të vitit 2019, të cilat sipas ndryshimit të legjislacionit do të trajtohen me 0 taksë.



BASHKIA KORÇË




**8. TAKSA E NDIKIMIT NË INFRASTRUKTURË NGA LEGALIZIMET**

Lloji i taksës	REALIZIM		PLANIFIKIM
	2018	2019 (i pritshëm)	2020
Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet	26,006,146	15,647,237	30,000,000

Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet për vitin 2020 është planifikuar 30,000,000 lekë parashikim ky i bërë nga Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit. Në lidhje me taksën e ndikimit në infrastrukturë nga objektet e legalizuara theksojmë se parashikimi për këtë taksë është në varësi të punës së A.SH.K. Duke ju referuar trendit të kësaj takse në 3 vitet e fundit dhe duke parë se pagesat e prapambetura janë pakësuar shumë si rezultat i bërjes së lajmërimeve të vazhdueshme.

Më poshtë po paraqesim grafikisht realizimin për vitin 2018, 2019 (i pritshëm) dhe planifikimin 2020 :





## BASHKIA KORÇË

### 9. TAKSA E FJETJES NË HOTEL

Lloji i taksës	REALIZIM		PLANIFIKIM
	2018	2019 (i pritshëm)	2020
Taksa e fjetjes në hotel	5,059,780	5,603,910	6,000,000


Planifikimi i të ardhurave për vitin 2020 i taksës së fjetjes në hotel është bërë duke u bazuar në numrin e njësisve që japin strehim kundrejt pagesës dhe përfshin emërtimet hotel, motel, stabiliment turistik, pension, shtëpi pritjeje, turizëm familjar dhe çdo objekt tjetër që përdoret për këtë qëllim si dhe kapacitet akomoduese të tyre.

Kjo taksë për vitin 2020 planifikohet në vlerën 6,000,000 lekë. Aktualisht numërohen 98 subjekte ( Bujtina, Hotel, Hostel) të detajuara si më poshtë:

- 28 bujtina me kapacitet akomodues 453 persona
- 68 hotele me kapacitet akomodues 1991 persona
- 2 hostele me kapacitet akomodues 21 persona.

Gjithashtu pritet që gjatë vitit 2020 të hyjnë në funksionim 7 bujtina dhe 12 hotele të cilët aktualisht janë duke investuar në këtë fushë. Arkëtim gjatë vitit 2020 do të ketë dhe nga ato subjekte të cilat nuk do ta paguajnë këtë taksë brenda vitit 2019 për vetë faktin se taksën e fjetjes në hotel për muajin dhjetor subjektet e paguajnë brenda datës 5 Janar të vitit 2020, gjithashtu dhe nga ato subjekte që nuk kanë paguar brenda afatit të përcaktuar këstet mujore të vitit 2019 apo dhe debitorë të viteve të mëparshme të cilat do të jenë objekt i masave shtrënguese konform legjislacionit në fuqi.

Më poshtë po paraqesim grafikisht realizimin për vitin 2018, 2019 (i pritshëm) dhe planifikimin 2020 :





BASHKIA KORÇË

10. TAKSA E TABELËS

Lloji i taksës	REALIZIM		PLANIFIKIM
	2018	2019 (i pritshëm)	2020
Taksa e Tabelës	9,551,861	9,002,673	10,000,000

Taksa e tabelës aplikohet për tre lloje tabelash, të përcaktuara sipas qëllimit të përdorimit dhe mënyrës së vendosjes së tyre:


**Tabela për qëllime identifikimi**, mbi 2 metra katror, të trupëzuara në sipërfaqen e ndërtesës ose brenda territorit ku zhvillon aktivitet biznesi dhe që nuk përdoren për të reklamuar aktivitetin e të tretëve. Në të tilla tabela vendoset emri dhe/ose lloji i aktivitetit të kompanisë. Tabelat me sipërfaqe më të vogël se 2 m<sup>2</sup> nuk taksohen.

**Tabela për qëllime reklamimi**, ku përfshihen tabelat që nuk janë brenda territorit të biznesit ose nuk janë të trupëzuara në sipërfaqen e ndërtesës, dhe që mund të jenë të thjeshta ose elektronike dhe që përdoren për të reklamuar aktivitetin e të tretëve .

**Tabela për qëllime ekspozimi**, ku përfshihen tabelat me karakter të përkohshëm, për ekspozime të ndryshme të hapura, panairë, spektakle, stenda reklamuese, banderola, etj.

Taksa e tabelës për vitin 2020 është planifikuar në vlerën 10,000,000 lekë, parashikim ky nga Drejtoria e Kontrollit të Territorit i cili bazohet në administrimin dhe pasurimin e të dhënave për numrin e subjekteve që kanë vendosur tabelë identifikuese për orientim, numrin e subjekteve që kanë vendosur tabelë identifikuese mbi 2 m<sup>2</sup> dhe sipërfaqen e tyre si dhe numrin e subjekteve që kanë vendosur tabelë reklamuese dhe sipërfaqen e tyre të ndodhura në Bashkinë Korçë si dhe ato që do të vendosin një të tillë përgjatë vitit 2020. Konkretisht kjo taksë planifikohet të arkëtohet nga subjektet që do të vendosin një të tillë përgjatë vitit 2020, nga 69 subjekte që aktualisht kanë vendosur tabelë reklamuese sipas përcaktimeve dhe niveleve të përcaktuara në ligj, me sipërfaqe totale prej 299.41 m<sup>2</sup> në vlerën 5,989,169.78 lekë, nga 37 subjekte që aktualisht kanë vendosur tabelë për qëllime identifikimi sipas përcaktimeve dhe niveleve të përcaktuara në ligj me sipërfaqe totale prej 175.81 m<sup>2</sup> në vlerën 2,379.743.33 lekë dhe 16 subjekte që aktualisht kanë vendosur tabelë identifikuese për orientim në vlerën 1,920 lekë. Gjithashtu po gjatë vitit 2020 planifikohen të mblidhen dhe detyrimet të cilat nuk arritën të mblidheshin për vitin 2019 dhe ato më përpara në vlerën 234,400 lekë.

Më poshtë po paraqesim grafikisht realizimin për vitin 2018, 2019 (i pritshëm) dhe planifikimin 2020 :





BASHKIA KORÇË

**11. DIVIDENTI NGA U.K.KO**

Lloji i taksës	REALIZIM		PLANIFIKIM
	2018	2019 (i pritshëm)	2020
Dividenti nga U.K.KO	7,864,515	15,515,582	9,000,000

Dividenti nga U.K.KO për vitin 2020 është planifikuar në vlerën 9,000,000 lekë planifikim ky i kryer nga ndërmarrja e U.K.KO.

**12. DIVIDENTI NGA TREGU I SHUMICËS**

Lloji i taksës	REALIZIM		PLANIFIKIM
	2018	2019 (i pritshëm)	2020
Dividenti nga Tregu i Shumicës	0	1,000,000	1,000,000

Dividenti nga Tregu i Shumicës për vitin 2020 është planifikuar në vlerën 1,000,000 lekë planifikim ky i kryer nga administrata e Tregut të Shitjes me Shumicë të Fruta – Perimeve.

**13. RENTA MINERARE**


Lloji i taksës	REALIZIM		PLANIFIKIM
	2018	2019 (i pritshëm)	2020
Renta minerare	110,375	207,229	350,000

Çdo person fizik apo juridik, që është i licensuar dhe/ose vepron në industrinë minerare, sipas një marrëdhënieje kontraktuale me ministrin përgjegjës për ekonominë, duhet të paguajë rentë minerare për burimet natyrore që nxjerr nga/mbi/dhe nëntoka. Renta minerare llogaritet si detyrim mujor i subjektit taksapagues, në çastin kur ai shet produkte minerare, 5 për qind e të ardhurave nga renta minerare i takojnë pushtetit vendor ku zhvillohet veprimtaria. Taksa e rentës minerare arkëtohet në rastin e shitjes së produkteve minerare brenda vendit ose në rastin e eksportit të produkteve minerare. Baza e taksës janë burimet natyrore që nxjerr nga nëntoka çdo person fizik apo juridik, në çastin kur ai shet produktin. Struktura e mbledhjes e kësaj takse janë: degët e doganave në rrethe të cilat ngarkohen për arkëtimin e kësaj rente në rastin e eksportit të produkteve minerare, ndërsa degët e tatimeve ngarkohen për arkëtimin e kësaj rente, në rastin e shitjes së produkteve minerare brenda vendit. Të ardhurat nga renta minerare përdoren për investime për njësitë e qeverisjes vendore. Për vitin 2020 kjo taksë planifikohet të aktëtohet në vlerën 350,000 lekë.



## BASHKIA KORÇË

Më poshtë po paraqesim grafikisht realizimin për vitin 2018, 2019 (i pritshëm) dhe planifikimin 2020 :



### 14. TARIFË REGJISTRIMI PËR LEJË TRANSPORTI

Lloji i tarifës	REALIZIM		PLANIFIKIM
	2018	2019 (i pritshëm)	2020
Tarifë regjistrimi për leje transporti	1,065,480	1,300,000	1,000,000


Tarifë regjistrimi për leje transporti për vitin 2020 është planifikuar në vlerën 1,000,000 lekë planifikim ky i bërë nga Drejtoria e Kontrollit të Territorit. Sipas kategorizimit ky parashikim do të realizohet si më poshtë:

1. Transporti i udhëtarëve me taksi planifikohet në vlerën 500,000 lekë (nga rinovimi i liçencave që përfundojnë gjatë vitit 2020).
2. Transporti i mallarave planifikohet në vlerën 250,000 lekë (në këtë kategori pjesën kryesore e zënë automjetet e subjekteve të ndërtimit me tonazh të lartë. Sipas kërkesave të subjekteve këto automjete në pjesën më të madhe janë pajisur me çertifikata dhe aurorizime me afat mbi 1-vjeçar).
3. Transporti i udhëtarëve me autobusë planifikohet në vlerën 100,000 lekë. Parashikimi këtu përfshin edhe pajisjen me çertifikata të autobusëve të subjekteve ekzistuese, si rrjedhojë e shtimit apo rinovimit të automjeteve.
4. Nja liçencimi i subjekteve të rinj planifikohet në vlerën 150,000 lekë, të cilat mund të aplikojnë gjatë vitit 2020.



## BASHKIA KORÇË

Më poshtë po paraqesim grafikisht realizimin për vitin 2018, 2019 (i pritshëm) dhe planifikimin 2020 :



### 15. **TARIFË THERJE BAGËTIE**


Lloji i tarifës	REALIZIM		PLANIFIKIM
	2018	2019 (i pritshëm)	2020
<b>Tarifë therje bagëtie</b>	<b>2,397,550</b>	<b>2,683,850</b>	<b>4,000,000</b>

Tarifë therje bagëtie për vitin 2020 është planifikuar 4,000,000 lekë, parashikim ky i Drejtorisë së Kontroll Territorit i cili bazohet në numrin e kontrolleve dhe çertifikimin e karkasave të gjedhëve të therura gjatë vitit 2019 dhe planifikimin për vitin 2020 nga të cilat planifikohen të realizohen 570,000 lekë, në numrin e kontrolleve dhe çertifikimin e karkasave të të imtave të therura gjatë vitit 2019 dhe planifikimin për vitin 2020 nga të cilat planifikohen të realizohen 2,336,000 lekë, në numrin e kontrolleve dhe çertifikimin e karkasave të derrave të therrur gjatë vitit 2019 dhe planifikimin për vitin 2020 nga të cilat planifikohen të realizohen 541,300 lekë, në numrin e kontrolleve dhe çertifikimin e karkasave të shpendëve që bazuar në informacionet që disponojmë do të theren gjatë vitit 2020 nga të cilat planifikohen të realizohen 420,000 lekë. Masat e mara për mbikqyrjen e sigurisë ushqimore, formalizimit të tregut, parandalimit të therjes së kafshëve në vende ilegale si dhe disiplinimin e therjes së kafshëve dhe tregtimit të mishit në të gjithë territorin e Bashkisë Korçë do të ndikojnë ndjeshëm në realizimin e kësaj tarife.

Më poshtë po paraqesim grafikisht realizimin për vitin 2018, 2019 (i pritshëm) dhe planifikimin 2020 :



## BASHKIA KORÇË



### 16. TARIFË MUR PERIMETRAL

Lloji i tarifës	REALIZIM		PLANIFIKIM
	2018	2019 (i pritshëm)	2020
Tarifë mur perimetral	628,832	721,100	800,000

Tarifë mur perimetral për vitin 2020 është planifikuar në vlerën 800,000 lekë parashikim ky i bërë nga Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit. Në lidhje me parashikimin e kësaj tarife i jemi referuar realizimit të 3 viteve të fundit si dhe ndryshimeve në paketën fiskale të vitit 2020. Gjithashtu ndikim do të ketë dhe efekti i ndërtimeve (meremetime, rikonstruksione dhe rindërtime) për të zhdukur dëmet e shkaktuara nga tërmetet e shpeshta të gjysmës së dytë të vitit 2019, të cilat sipas ndryshimit të legjislacionit do të trajtohen me 0 taksë.

### 17. TARIFA E PASTRIMIT

Lloji i tarifës	REALIZIM		PLANIFIKIM
	2018	2019 (i pritshëm)	2020
Tarifa e Pastrimit	155,983,218	168,000,000	191,267,500

Tarifa e pastrimit për vitin 2020 planifikohet në vlerën 191,267,500 lekë. Kjo tarifë planifikohet të arkëtohet nga 3,532 subjekte aktive efektive në total dhe konkretisht nga 2,878 subjekte të biznesit të vogël në vlerën 29,168,300 lekë, nga 654 subjekte të biznesit të madh në vlerën 35,538,000 lekë, nga 80 institucione shtetërore dhe ojf në vlerën 1,890,000 lekë, nga subjektet ndërtuese për kantieret e ndërtimit referuar numrit të lejeve të dhëna gjatë vitit 2019 në vlerën 3,800,000 lekë, nga 20,087 familje rezidente efektive të njësisë administrative Korçë në vlerën 76,330,600 lekë, nga 7,017 familje rezidente efektive të njësisë administrative të tjera të Bashkisë Korçë në vlerën 10,336,500 lekë si dhe nga debitorët familjarë në vlerën 14,379,100 lekë dhe debitorët e subjekteve të biznesit parashikohet në vlerën 19,825,000 lekë.



## BASHKIA KORÇË

Në planifikimin e tarifës së pastrimit ndikim negativ pritet të kenë dhe lehtësitë fiskale apo dhe përjashtimet të cilat u miratuan së fundmi si një paketë lehtësuese që bashkia ndërmer për bizneset. Konkretisht në planifikimin e kësaj tarife për vitin 2020 vlera prej 2,270,200 lekë do ti mungojë buxhetit të bashkisë por do jetë në buxhetet e sipërmarrjeve private si një mundësi për shtim dhe rritjen e kapaciteteve, aktiviteve, punësimit, zgjerimit e.t.j


1. Subjekte të cilat përfitojnë 20 % ulje të tarifës së pastrimit, referuar të dhënave paraprake që disponojmë janë 52 subjekte me një ndikim në buxhetin e bashkisë me një vlerë prej 489,200 lekë :
  - Për aktivitetin tregëti dhe shërbime në vlerën 230,000 lekë
  - Për aktivitetin prodhim në vlerën 192,000 lekë
  - Institucione arsimore private në vlerën 67,200 lekë
2. Subjekte të cilat përfitojnë 50 % ulje të tarifës së pastrimit, referuar të dhënave paraprake që disponojmë janë 21 subjekte me një ndikim në buxhetin e bashkisë me një vlerë prej 581,000 lekë :
  - Për aktivitetin tregëti dhe shërbime në vlerën 75,000 lekë
  - Për aktivitetin prodhim në vlerën 440,000 lekë
  
  - Ojft sportive në vlerën 30,000 lekë
  - Dedikuar fëmijëve në vlerën 36,000 lekë
3. Subjekte që përjashtohen nga pagesa e tarifës së pastrimit referuar të dhënave paraprake që disponojmë janë 25 subjekte me një ndikim në buxhetin e bashkisë me një vlerë prej 1,200,000 lekë :
  - Subjekte të biznesit në vlerën 720,000 lekë
  - Ojft fetare në vlerën 480,000 lekë

Kriteri bazë për vendosjen e tarifës së pastrimit është kostoja e këtij shërbimi, kosto e cila paguhet nga bizneset apo familjet të cilat kontribuojnë dhe e përfitojnë shërbimin e pastrimit. Tarifa e pastrimit mbledhet nga dy struktura, Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore në lidhje me tarifën e pastrimit për kategorinë e biznesit dhe për kategorinë familjarë nga U.K.KO.



## BASHKIA KORÇË

Më poshtë po paraqesim grafikisht realizimin për vitin 2018, 2019 (i pritshëm) dhe planifikimin 2020 :



### 18. TARIFE NDRIÇIMI

Lloji i tarifës	REALIZIM		PLANIFIKIM
	2018	2019 (i pritshëm)	2020
<b>Tarifë Ndrëçimi</b>	<b>37,942,813</b>	<b>38,072,500</b>	<b>44,588,400</b>

Bashkia e qytetit të Korçës sjell traditën e përvitshme "Festa e Lakrorit" me qëllim gjallërimin e jetës së qytetit si dhe rizgjimimin dhe promovimin e vlerave të qytetit, duke e bërë atë sa më atraktiv për turistët vendas dhe të huaj

Festa e lakrorit njihet si një nga festat me tradicionale të qytetit ku ndërthur gatimin tradicional, lojrat dhe elementë të tjerë të cilat krijojnë një atmosferë argetuese në qytetin e Korçës për të tërhequr turistë brenda dhe jashtë vendit dhe duke e kthyer atë e në një pikë atraktive për turistët.

Si qyteti i kulturës, arsimit, serenatave, kulinarisë dhe festave, Korca mirëpret të gjithë ata që e duan natyrën e bukur, artin, argëtimin pa fund dhe traditën.

### **Qëllimi:**

Promovimi i vlerave tradicionale të artit të gastronomisë dhe nxitja dhe promovimi i produkteve të rajonit, nëpërmjet aktiviteteve të cilat tërheqin numër të madh vendasish dhe të huaj

### **Objektiva:**

- Rritja e numrit të vizitorëve



## BASHKIA KORÇË

- Rritja e të ardhuravë të bizneseve që lidhen direkt apo indirekt me turizmin (Bare, restorante, hotele etj)
- Gjallërimi i jetës në qytet përmes realizimit të aktivitetit
- Trashëgimia e kulturës dhe traditës korçare në vitet e ardhshme
- Zhvillimi i turizmit në rajon, promovimi i qytetit si dhe forcimi i traditave të Korçës dhe rrethinave .
- Me qëllim gjallërimin e jetës së qytetit si dhe rizgjimimin dhe promovimin e vlerave të qytetit

### **Përfituesit / Treguesit**

- 30 gra/ amvisa të cilat përfshihen direkt në organizimin dhe zhvillimin e festës së lakrorit duke përgatitur lakrorin në saç.
- Festa e lakrorit ndikon pozitivisht në rritjen dhe zhvillimin ekonomik të zonës duke iniciuar krijimin e sipërmarrjeve individuale të 30 grave pjesëmarrëse në festë
- 10 bizneset e zonës
- 2000 vizitorët (qytetarë vendas dhe të huaj) të cilët shijojnë jo vetëm traditën e kulinarisë por dhe vlerat kulturore të Polenës.

### **Programi i Aktiviteteve:**

- Ngritja e grupit të punës
- Kontakti me pjesëmarrësit për bashkëpunim
- Identifikimi i vendit më të përshtatshëm
- Realizimi i infrastrukturës në (marrje me qera aparate, pajisje teknike ,makineri, tavolina, stola, saçe)
- Realizimi i materialeve promocionale (bluza, kapele, përparëse, baner, fletëpalosje)
- Realizimi i transportit (vajtje- ardhje) dhe shpenzime të tjera (materiale për prodhimin e lakrorit)
- Lajmërimi i qytetarëve
- Kontakti dhe përgatitja
- Kontakti me biznese dhe donatorë
- Promovim dhe marketing
- Realizimi i eventit

### **Risia dhe Qëndrueshmëria e projektit:**

Për më shumë se 10 vite rradhazi “Festa e Lakrorit” zhvillohet ne qytetin e Korçës dhe synon rritje të numrit të pjesëmarrësve.

### **Rezultate:**

- Gjallërimi i jetës kulturore, artistike në Rajonin e Korçës
- Rritja e numrit të vizitorëve
- Promovim i produkteve të Rajonit
- Promovim i vlerave kulturore
- Rritja e numrit të të rinjve si frekuentues të aktiviteteve të organizuara nga bashkia



## BASHKIA KORÇË

**Kostoja Totale: 333,000 Lekë**

**Institucioni Zbatues: Bashkia Korçë**

**Struktura Përgjegjëse: Drejtoria e projekteve, integritit europian, koordinimit me donatorët dhe turizmit.**

**Shënime:** Festa e Lakrorit zhvillohet në fshatin e Polenës.

**Titulli i Projektit:** Festa e Mollës

**Kohëzgjatja:** Shtator- Tetor 2020

### **Përshkrim i shkurtër i projektit:**

“Festa e mollës” tashmë një festë e kthyer në traditë, e organizuar për të disatin vit radhazi nga Bashkia Korçë, në zonën e Dvoranit, zonë e njohur për prodhimin e mollës, do të konsistojë në aktivitet të pasur ku do të ndërthurret tradicionalja me prodhimet vendase dhe moderne. Në këtë aktivitet do të jenë të pranishëm biznese që merren me grumbullimin dhe përpunimin e produkteve agro, fermerë të zonës si dhe qytetarë, të cilët do të shijojnë prodhimet e rajonit të Korçës. Bizneset dhe fermerët do të prezantojnë produktet e tyre, do të hapin dyert për të gjithë vizitorët vendas dhe të huaj për të qënë pjesë e vjeljes së mollëve tek fermat e tyre. Vizita në fermë, takim me bizneset dhe fermerët, panair me baze frutin e mollës dhe produkte të tjera kulinarie të gatuar dhe përgatitura nga amvisat e këtij vendi si petulla me mollë, reçel molle, prevede etj. Duke besuar në suksesin e këtij projekti, synojmë përsëritjen e tij çdo vit duke e pasuruar gjithnjë me të tjerë elemente.

### **Qëllimi:**

Qëllimi i organizimit të këtij projekti është nxitja dhe promovimi i produkteve të rajonit, nëpërmjet aktiviteteve të cilat tërheqin numër të madh vendasish dhe të huaj.

### **Objektiva:**

- Promovimi i produkteve të rajonit
- Rritja e numrit të frekuentimit të zonave përreth Korçës.
- Gjallërimi i jetës sociale dhe kulturore
- Zhvillimi i ekonomisë lokale tek kjo zonë

### **Përfituesit / Treguesit**

- 20 gra/ amvisa të cilat përfshihen direkt në organizimin dhe zhvillimin e festës së mollës



## BASHKIA KORÇË

- Festa e Mollës ndikon pozitivisht në rritjen dhe zhvillimin ekonomik të zonës duke iniciuar krijimin e sipërmarrjeve individuale të grave pjesëmarrëse në festë
- Bizneset e zonës
- mbi 30 fermerë të zonës të cilët promovojnë dhe tregëtojnë varietete e ndryshme të mollës
- mbi 500 vizitorët ( qytetarë vendas dhe të huaj) të cilët shijojnë jo vetëm traditën e kulinarisë por dhe vlerat kulturore të Dvoranit.
- Fëmijët pjesmarrës në vjeljen e mollëve si dhe në aktivitetet argëtuese dhe çlodhëse

### **Programi i Aktiviteteve:**

- Mbledhja e mollëve në një nga Fermat e Dvoranit
- Dekor i veçantë tek sheshi ku do të zhvillohet Festa (*Dekori Festiv i parashikuar si zë në buxhetin e festës do të përdoret për krijimin e elementëve të ndryshëm dekorativë si elementë ndriçimi, struktura metalike ose druri të ndriçuara, printime në forex etj. Grupi i punës specifikon detajet e dekorit festiv 45 ditë përpara procedurës së prokurimit).*
- Markimi i bizneseve të cilat do të marrin pjesë në Festë
- Koncert festiv
- Panairi i molleve, në bashkëpunim me bizneset grumbulluese dhe përpunuese të produkteve agro si dhe fermerët e rajonit do te zhvillohet panairi i produkteve agro, duke promovuar kështu produktet e zonës së Korçës. Pjesë e panairit do të jenë edhe gatimet e shumta me bazë mollët, të cilat do të reklamohen nga amvisat e kësaj zone
- Realizmi i materialeve promocionale (*çanta letre të riciklueshme për mbledhjen e mollëve, kapela dhe përparëse, fletpalosje, baner etj*)
- Aktivitete për fëmijë (kënd i dedikuar fëmijëve me aktivitete te ndryshme edukative dhe argëtuese)
- Promovim i eventit
- Menaxhimi i eventit
- Realizmi i festës së mollës

### **Risia dhe Qëndrueshmëria e projektit:**

Festa e Mollës organizohet për të disatin vit radhazi duke shënuar rritje të bizneseve agropërpunuese pjesëmarrëse. Synojmë që këtë vit Festën e Mollës ta kthejmë në një magnet për tërheqjen e sa më shumë vizitorëve.



## BASHKIA KORÇË

### **Rezultate:**

- Rritje të numrit të vizitorëve vendas dhe të huaj
- Promovimi i produkteve tipike lokale
- Impakt direkt në rritjen e zhvillimit ekonomik
- Gjallërimi i jetës sociale dhe kulturore
- Përforsim i imazhit turistik të vendit

**Kostoja Totale: 358,000 Lekë**

**Institucioni Zbatues:** Bashkia Korçë

**Struktura Përgjegjëse:** Drejtoria e projekteve, Koordinimit me Donatorët dhe Turizmit

**Shënime:** Projekti do të implementohet nga Bashkia Korçë në bashkëpunim me bizneset pjesëmarrëse në panairin e mollëve.

**Titulli i Projektit:** 2B Festival

**Kohëzgjatja:** Gjatë muajit shtator 2020

### **Përshkrim i shkurtër i projektit:**

Bashkia e Korçës në kuadrin e zhvillimit ekonomik, social dhe kulturor të qytetit si dhe për të nxitur dhe promovuar talentet e reja muzikore do të organizojë në shtator 2020 2B Festival ku do të marrin pjesë grupe të reja rock-u jo vetëm nga Shqipëria por edhe nga trevat shqiptare, si Maqedoni dhe Kosovë, të cilët do të performojnë live për një periudhë tre ditore në një prej destinacioneve më atraktive dhe turistike siç është “Pazari i Vjetër” i Korçës duke krijuar mundësi për të gjithë të apasionuarit e muzikës rock që të argëtohen nën tingujt e kësaj muzike.

Festivali i rokut, krahas shumë festave dhe eventeve madhore që realizohen në Korçë, do të jetë një tjetër aktivitet madhor, i cili do të zhvillohet çdo vit duke shndërruar qytetin në promotorin e muzikës rock.

**Qëllimi:** Zhvillimi i turizmit në rajon si dhe promovimi i qytetit përmes aktiviteteve kulturore.

### **Objektiva:**

- Rritja e numrit të vizitorëve
- Rritja e të ardhuravë të bizneseve që lidhen direkt apo indirekt me turizmin (bare, restorante, etj)
- Gjallërimi i jetës në qytet përmes realizimit të aktivitetit



## BASHKIA KORÇË

- Zhvillimi i turizmit në rajon, promovimi i qytetit si dhe forcimi i traditave të Korçës dhe rrethinave .
- Promovimi i grupeve me artistë të rinj

### **Përfituesit/ Treguesit**

- 2B Festival bën bashkë:
- mbi 10 grupe të reja të muzikës rock jo vetëm nga Shqipëria por dhe nga trevat e tjera shqiptare si Kosovë dhe Maqedoni
- Të gjithë të rinjtë e rajonit të apasionuar pas muzikës rock
- Vizitorë vendas dhe të huaj

### **Programi i Aktiviteteve:**

- Ngritja e grupit të punës
- Kontakti me pjesëmarrësit për bashkëpunim
- Realizimi i infrastrukturës në (marrje me qera skene pajisje, skenë, foni, ndriçim)
- Realizimi i dekorit festiv
- Realizimi i materialeve promocionale (baner, ftesa, citylight, etj)
- Lajmërimi i qytetarëve
- Kontakti dhe me biznese dhe donatorë
- Promovim dhe marketing
- Realizimi i eventit

### **Risia dhe Qëndrueshmëria e projektit:**

2B Festival synon që të kthehet në traditë dhe me një pjesëmarrje më të lartë çdo vit .

### **Rezultate:**

- Gjallërimi i jetës kulturore, artistike në Rajonin e Korçës
- Rritja e numrit të vizitorëve
- Promovim i zonës
- Promovim i vlerave kulturore
- Rritje të numrit të të rinjve që frekuentojnë aktivitetet e organizuara nga Bashkia Korçë

**Kostoja Totale: 1.300.000 Lekë**

**Institucioni Zbatues:** Bashkia Korçë

**Struktura Përgjegjëse:** Drejtoria e projekteve, integritit europian, koordinimit me donatorët dhe turizmit.

**Shënime:** 2B Festival do të zhvillohet në Qendër të Pazarit të Vjetër të qytetit të Korçës

**Titulli i Projektit:** Dita e Balonave

**Kohëzgjatja:** Gjatë vitit 2020

**Përshkrim i shkurtër i projektit:**



## BASHKIA KORÇË

Një traditë e re i bashkangjitet pasurimit kulturor dhe aktiviteteve në qytetin e Korçës siç është Dita e Balonave. Ky aktivitet ka në thelb jo vetëm argëtimin e fëmijëve por gjithashtu rikthimi e traditës së piknikut. Dita e Balonave do të zhvillohet në Voskopojë duke synuar pjesëmarrje të të gjithë grupmoshave.

### **Qëllimi:**

Promovimi i Voskopojës si destinacion turistik dhe rritja e numrit të eventeve për të sjellë më shumë turistë.

### **Objektiva:**

- Promovimi i fshatit turistik Voskopojë
- Rritja e numrit të turistëve vendas dhe të huaj
- Rritja e numrit të aktiviteteve argëtuese dhe edukuese për fëmijë
- Rikthim i traditës së piknikut
- Njohja e fëmijëve me vlerat e trashëgimisë kulturore që ofron Voskopoja

### **Përfituesit/ Treguesit**

- Mbi 200 fëmijë të grupmoshave të ndryshme do të jenë pjesë e aktivitetit të balonave
- Familjet që do të jenë pjesë e aktivitetit të piknikut  
Banorët e Voskopojës dhe Korçës
- Bizneset lokale të zonës

### **Programi i Aktiviteteve:**

- Ngritja e grupit të punës
- Përgatitja e materialeve promicionale (baner, fletëpalosje një fletëshe, kapele & bluza me logon “Dita e Balonave”, etj.)
- Realizimi i infrastrukturës ( marrje me qera set tavolina, stola, foni etj )
- Lajmërimi i qytetarëve, familjeve, fëmijëve
- Kontakti dhe përgatitja me bizneset e donatorët
- Promovimi i eventit në media dhe në rrjete sociale
- Menaxhimi dhe realizimi i tij



## BASHKIA KORÇË

### **Risia dhe Qëndrueshmëria e projektit:**

Dita e Balonave realizohet për herë të parë dhe synojmë ta kthejmë në një festë të përvitshme. Risia e kësaj feste është nxitja e fëmijëve për t'u marrë me aktivitete rekreative.

### **Rezultate:**

- Promovimi i fshatit turistik të Voskopojës dhe vlerave kulturore të saj
- Gjallërim dhe pasurim i jetës sociale
- Përfshirja e fëmijëve në aktivitete krijuese

**Kostoja Totale:** 209,000 Lekë

**Institucioni Zbatues:** Bashkia Korçë

**Struktura Përgjegjëse:** Drejtoria e Projekteve, Koordinimit me Donatorët dhe Turizmit.

**Shënime:** Dita e Balonave do të zhvillohet në fshatin turistik të Voskopojës.

**Titulli i Projektit:** Rrëfej Voskopojën

**Kohëzgjatja:** Gjatë vitit 2020

### **Përshkrim i shkurtër i projektit:**

Voskopoja, një qendër kulturore dhe historike e rëndësishme e cila po kthehet në fshatin turistik model në Shqipëri. "Rrëfej Voskopojën" është festa që organizohet për të tretin vit radhazi, kjo festë krijon një atmosferë tepër të veçantë në Voskopojë, e cila tregon më të mirën që ofron ky atraksion turistik, duke nisur nga trashëgimia kulturore, legjendat e banorëve, historia, prodhimet tradicionale, aktivitetet sportive, e për t'u mbyllur me një koncert me muzikë live. Voskopoja mbetet gjithmonë atraksioni më i preferuar dhe më tërheqës për të gjithë vizitorët vendas dhe të huaj.

### **Qëllimi:**

Qëllimi i organizimit të këtij projekti është nxitja dhe promovimi i produkteve të rajonit, nëpërmjet aktiviteteve të cilat tërheqin numër të madh vendasish dhe të huaj.

### **Objektiva:**

- Promovimi i produkteve të rajonit
- Rritja e numrit të frekuentimit të zonave përreth Korçës.
- Gjallërimi i jetës sociale dhe kulturore



## BASHKIA KORÇË

- Zhvillimi i ekonomisë lokale tek kjo zonë

### **Përfituesit/ Treguesit**

- 35 gra/ amvisa të cilat përfshihen direkt në organizimin dhe zhvillimin e festës së Voskopojës duke përgatitur panairin e kulinarisë, produktet tipike si dhe produktet e artizanatit.
- Festa e Voskopojës ndikon pozitivisht në rritjen dhe zhvillimin ekonomik të zonës duke synuar dhe iniciuar krijimin e sipërmarrjeve individuale të grave pjesëmarrëse në festë
- 20 bizneset e zonës
- mbi 1000 vizitorët ( qytetarë vendas dhe të huaj) të cilët shijojnë jo vetëm traditën e kulinarisë por dhe vlerat e trashëgimisë kulturore të Voskopojës

### **Programi i Aktiviteteve:**

- Ngritja e grupit të punës
- Dekor i veçantë tek sheshi ku do të zhvillohet Festa (*Dekori Festiv i parashikuar si zë në buxhetin e festës do të përdoret për krijimin e elementëve të ndryshëm dekorativë si elementë ndriçimi, struktura metalike ose druri të ndriçuara, printime në forex etj. Grupi i punës specifikon detajet e dekorit festiv 45 ditë përpara procedurës së prokurimit).*
- Markimi i bizneseve të cilat do të marrin pjesë në Panair
- Koncert festiv
- Panairi i produkteve kulinare në bashkëpunim me bizneset e zonës
- Realizmi i materialeve promocionale
- Promovim e eventit
- Menaxhimi i eventit
- Realizmi i festës "Rrëfej Voskopojën"

### **Risia dhe Qëndrueshmëria e projektit:**

"Rrëfej Voskopojën" është festa që organizohet për të tretin vit radhazi, synojmë që këtë vit këtë festë ta kthejmë në një magnet për tërheqjen e sa më shumë vizitorëve.

### **Rezultate:**

- Rritje të numrit të vizitorëve vendas dhe të huaj
- Promovimi i produkteve tipike lokale
- Impakt direkt në rritjen e zhvillimit ekonomik
- Gjallërimi i jetës sociale dhe kulturore
- Përforsim i imazhit turistik të vendit

**Kostoja Totale:** 381,400 Lekë



## BASHKIA KORÇË

**Institucioni Zbatues:** Bashkia Korçë

**Struktura Përgjegjëse:** Drejtoria e projekteve, Koordinimit me Donatorët dhe Turizmit

**Shënime:** Projekti do të implementohet nga Bashkia Korçë në bashkëpunim me bizneset pjesëmarrëse në panairin e kulinarisë.

### Titulli i Projektit: Tour Operator

**Kohëzgjatja:** Gjatë vitit 2020

#### Përshkrim i shkurtër i projektit:

Realizimi dhe promovimi i paketave turistike luajnë një rol kyç në fushën e turizmit duke rritur numrin e turistëve vendas dhe të huaj. Bashkia Korçë do të organizojë një tour operator me agjensitë turistike të cilat sjellin turistë të huaj në Shqipëri për të përfshirë dhe promovuar qytetin dhe vlerat e tij kulturore, sociale, argëtuese dhe ekonomike.

#### Qëllimi:

Zhvillimi i turizmit në rajon, promovimi i qytetit si dhe forcimi i lidhjeve me agjensitë turistike që sjellin turistë të huaj në Korçë.

#### Objektiva:

- 1) Zhvillimi i turizmit në rajon, promovimi i qytetit si dhe forcimi i traditave të Korçës dhe rrethinave .
- 2) Promovimi i zonës dhe fshatrave turistike përreth saj
- 3) Promovimi i vlerave të trashëgimisë kulturore
- 4) Forcimi i marrëdhënive me agjensitë turistike për rritje të numrit të vizitorëve
- 5) Promovimi i qytetit në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar
- 6) Vendosi të urave të bashkëpunimit mes agjensive turistive dhe bizneseve lokale që operojnë në fushën e turizmit

#### Përfituesit/ Treguesit

- Bizneset lokale të rajonit që operojnë në fushën e turizmit
- Të gjithë banorët vendas të rajonit



## BASHKIA KORÇË

### **Programi i Aktiviteteve:**

- Identifikimi i agjensive turistike që operojnë në Shqipëri, Greqi, Maqedoni
- Kontaktimi i agjensive turistike dhe njohja me paketat dhe ofertat turistike që ofrojnë
- Prodhimi i materialeve promocionale (hartë qyteti)
- Hartimi i ftesës dhe programit të vizitës
- Promovimi i atraksioneve dhe vlerave kulturore dhe trashëgimisë që ofron Korça
- Realizmi i një turi në qytet për të promovuar atraksionet turistike

### **Risia dhe Qëndrueshmëria e projektit:**

Ky projekt do të shërbejë për të promovuar Korçën si destinacion turistik përmes paketave të ndryshme që do të ofrojnë agjensitë turistike. Vendosija e marrëdhënieve të bashkëpunimi me këto agjensitë do të ndikojë në rritjen e numrit të turistëve në qytet.

### **Rezultate:**

- Promovimi i qytetit dhe atraksioneve të tij në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar
- Rritje të numri të turistëve
- Rritje të numrit të paketave të turistike për Korçën
- Rritje e kohëqëndrimit të vizitorëve
- Bashkëpunimit mes agjensive turistive dhe bizneseve lokale që operojnë në fushën e turizmit

**Kostoja Totale:** 305,000 Lekë

**Institucioni Zbatues:** Bashkia Korçë

**Struktura Përgjegjëse:** Drejtoria e hartimit të projekteve, koordinimit me donatorët dhe turizmit

**Shënime:** Projekti do të realizohet në bashkëpunim me agjensitë turistike që operojnë në Shqipëri, Greqi dhe Maqedoni.

**Titulli i Projektit:** Festa e Valles

**Kohëzgjatja:** Gjate vitit 2020

**Përshkrim i shkurtër i projektit:**

Dardha, përveç destinacionit të mirëfilltë turistik, i cili është një nga pikat më tërheqëse në çdo stinë, rrezaton edhe një kulturë intelektuale e popullore që e bën atë të gëzojë një traditë të pasur në vlera. Bashkia Korçë organizon këtë vit “Festën e Valles” në fshatin turistik për të rivitalizuar vlerat, gjuhën, historinë, traditat, veshjet dhe gatimet në bashkëpunim me grupe të ndryshme të artit që do të përformojnë dhe pse jo për ta kthyer atë në një traditë çdo vit.



## BASHKIA KORÇË

### Qëllimi:

Promovimi i Dardhës si destinacion turistik me qëllim rritjen e numrit të turistëve dhe mikpritjen e tyre.

### Objektiva:

- Zhvillimi i zonës si destinacion turistik
- Përmirësimi i paketës turistike që ofron Dardha
- Promovimi i elementëve të trashëgimisë

### Përfituesit/ Treguesit

- Banorët e Dardhës

- 5 % e grave pjesëmarrëse në aktivitetet për të folur rreth elementëve dhe simbolit të kostumit dardhar

- Vizitorët vendas dhe të huaj

### Programi i Aktiviteteve:

- Ngritja e grupit të punës
- Mbledhja e informacionit të nevojshëm
- Identifikimi i vendit më të përshtatshëm
- Kontakti i pjesëmarrësve për bashkëpunim
- Realizimi i infrastrukturës (marrje me qera, tavolina, stola, aparate teknike, pajisje teknike, makineri etj )
- Realizimi i materialeve promociionale (dizenjim, printim fletëpalosjesh, baner,etj)
- Realizimi i transportit (transporti i pjesëmarrësve vajtje-ardhje Korçë-Dardhë dhe anasjelltas)
- Realizimi i dekorit festiv (*Dekori Festiv i parashikuar si zë në buxhetin e festës do të përdoret për krijimin e elementëve të ndryshëm dekorativë si elementë ndriçimi, struktura metalike ose druri të ndriçuara, printime në forex etj. Grupi i punës specifikon detajet e dekorit festiv 45 ditë përpara procedurës së prokurimit*)
- Realizimi i valleve nga grupet kuratore ( Let's Dance dhe House of Art)
- Lajmërimi i qytetarëve të interesuar për të marrë pjesë në event
- Kontakti i mundshëm me biznese dhe donatorë
- Promovim & marketing në mediat sociale
- Realizimi eventit

### Risia dhe Qëndrueshmëria e projektit:

Festa e valles synon për vitet e ardhshme sukses dhe një pjesëmarrje më të lartë dhe zgjerim aktivitetesh.

### Rezultate:

- Nje risi e re në fshatin turistik të Dardhës
- Rritja e turizmit dhe të ardhurave në biznes



## BASHKIA KORÇË

- Promovimi i fshatit dhe strukturës së tij si një fshat që mund të vizitohet në çdo stinë
- Njohja dhe promovimi i kulturës dhe traditës dardhare

**Kostoja Totale: 261,000 Lekë**

**Institucioni Zbatues:** Bashkia Korçë

**Struktura Përgjegjëse:** Drejtoria e Projekteve, Integritit europian, Koordinimit me Donatorët dhe Turizmit.

**Shënime:**

Festa e valles zhvillon aktivitetin e saj në fshatin turistik të Dardhës me bashkëpunimin e grupeve të ndryshme të valleve të qytetit të Korçës.

**Titulli i Projektit: Rrënjët e qytetit tim**

**Kohëzgjatja: 3 muaj**

**Përshkrim i shkurtër i projektit:**

Në kuadrin e promovimit të vlerave turistike, arkitekturore dhe kulturore të qytetit të Korçës do të organizohet një eskpozitë fotografie ku do të ftohen të rinj të qytetit të Korçës të apasionuar për fotografinë.

**Qëllimi:**

Promovimi i vlerave turistike, arkitekturore dhe kulturore të qytetit të Korçës në syrin rinor

**Objektiva:**

- Evidentimi i talenteve të të rinjve në fushën e fotografisë
- Promovimi i vlerave turistike, kulturore dhe arkitekturore të qytetit

**Programi i Aktiviteteve:**

- Ngritja e grupit të punës
- Reklamimi dhe njoftimi në media dhe media sociale të të gjithë të interesuarve për të qënë pjesë e këtij aktiviteti.
- Mbledhja e fotografive si dhe selektimi i tyre nga juria
- Printimi i fotografive në forex
- Zhvillimi i aktivitetit
- Vlerësimi i pjesëmarrësve

**Risia dhe Qëndrueshmëria e projektit:**

Ky aktivitet zhvillohet për herë të parë dhe në fokus të saj janë të rinjtë. Angazhimi i tyre në promovimin e qytetit dhe investimeve që janë bërë në të.



## BASHKIA KORÇË

### Rezultate:

- Krijimi i aktivitetit me sukses
- Krijimi i fotografive që mund të përdoren dhe si suvenir për qytetin

**Kostoja Totale: 195.500 Lekë**

**Institucioni Zbatues: Bashkia Korçë**

**Struktura Përgjegjëse: Njësia e Integritimit Evropian**

### Titulli i Projektit: Festa e Mjaltit

**Kohëzgjatja: Përgjatë muajit Maj 2020**

### Përshkrim i shkurtër i projektit:

Korça , një nga zonat më të rëndësishme për prodhimin e mjaltit dhe nënprodukteve të tjera do të sjellë këtë vit, duke e kthyer si pjesë të traditës se saj, ” Festën e Mjaltit”. Kjo festë vjen dhe si mesazh sensibilizues në ditën botërore të bletës me pjesëmarrjen e shumë bletërritesve nga të gjitha zonat. Aktivitete të shumta do të zhvillohen duke përfshirë, panair mjalti, koncert festiv si dhe argëtim për fëmijë përgjatë zonës këmbësore në qendër të qytetit. Në këtë ditë vlerësohet dhe garantohet mbështetje për punën e shumë bletërritësve nga të gjitha zonat për prodhimin e mjaltit dhe nënproduktet e tij nga më cilësorët.

### Qëllimi:

Nxitja dhe promovimi i produkteve tipike te rajonit duke bërë bashkë shumë treva shqiptare (Maqedoni, Kosovë dhe Greqi) nëpërmjet aktiviteteve që tërheqin vëmendjen e vizitorëve.

### Objektiva:

- Promovimi i mjaltit si produkt lokal
- Gjallërimi i jetës sociale dhe kulturore përmes aktiviteteve
- Ndërgjegjësim në kuadrin e ditës botërore të bletëve
- Rritje të numrit të vizitorëve
- Shkëmbim traditash kulturore

### Përfituesit / Treguesit

- Bizneset lokale të Korçës që prodhojnë mjaltin dhe nënproduktet e tij
- Qytetarët vendas dhe të huaj që do të bëhen pjesë e panairit
- Bletërritësit e ftuar nga trevat e tjera të Shqipërisë

### Programi i Aktiviteteve:

1. Ngritja e grupit të punës i cili, do të merret me realizimin e festës



## BASHKIA KORÇË

2. Kontakte me shoqatën e bletërritësve për mënyrën e zhvillimit të aktivitetit
3. Realizimi i ftesave për bletërritësit që do jenë pjesë e panairit
4. Realizimi i materialeve të tjera promocionale (baner, fletëpalosje, bluza, çertifikata për pjesëmarrësit etj)
5. Kontakti me shkollat e qytetit për lajmërimin e nxënësve
6. Realizimi i infrastrukturës së nevojshme për panairin e mjaltit (marrje me qera, stenda, marrje me qera aparatura dhe pajisje të tjera)
7. Realizimi i koncertit festiv
8. Promovimi në media dhe rrjete sociale
9. Menaxhimi dhe realizimi i festës së mjaltit

### **Risia dhe Qëndrueshmëria e projektit:**

Festa e mjaltit organizohet në bashkëpunim me shoqatën e bletërritësve, i cili është një faktor kyç për qëndrueshmërinë e këtij projekti (numër i lartë i bletërritësve nga rajoni i Korçës pjesë e festës)

### **Rezultate:**

- Pjesëmarrja e shumë bletërritësve nga të gjitha trevat
- Mesazh sensibilizues për ndërgjegjësimin e ditës boterore të bletëve
- Shkëmbim dijesh, zakonesh dhe traditash me vendet e tjera
- Numër i lartë vizitorësh

**Kostoja Totale: 149,000 Lekë**

**Institucioni Zbatues:** Bashkia Korçë

**Struktura Përgjegjëse:** Drejtoria e projekteve, integritit europian, koordinimit me donatorët dhe turizmit.

**Shënime:** Festa e Mjaltit realizohet në bashkëpunim me Shoqatën e Bletërritësve.

**Titulli i Projektit:** Festa e Vithkuqit

**Kohëzgjatja:** Gjatë vitit 2020

**Përshkrim i shkurtër i projektit:**



## BASHKIA KORÇË

Bashkia e qytetit të Korçës do të risjellë këtë vit eventin “Festa e Vithkuqit” me synimin për të rivitalizuar promovimin e potencialeve turistike, vlerave që ka zona, traditën dhe trashëgiminë kulturore. Kjo festë përfshin një numër të gjërë aktivitetesh si; koncert festiv, panair kulinarie, aktivitete për fëmijë, etj.

### **Qëllimi:**

Promovimi i vlerave të artit të gastronomisë, nxitja si një destinacion turistik përmes promovimit të vlerave tradicionale të zonës.

### **Objektiva:**

- Nxitja dhe promovimi i produkteve të zonës nëpërmjet aktiviteteve për të tërhequr numër të madh turistësh
- Promovim i traditës dhe vlerave artizanale, kulinarisë të fshatit, si dhe pasurisë folklorike dhe kulturore
- Tërheqja e vizitorëve vendas dhe të huaj të apasionuar mbas kulturave dhe traditave
- Gjallërimin dhe promovimin e bizneseve të fshatit
  
- Tërheqja e investitorëve për të shtuar numrin e bizneseve në fshat

### **Përfituesit/ Treguesit**

- 25 % e komunitetit (femra dhe meshkuj) pjesmarrës aktivë në organizimin e Festës së Vithkuqit
- mbi 10% e grave pjesmarrëse në panairin e kulinarisë dhe artizanatit që do të realizohet gjatë festës lokale, me qëllim promovimin dhe tregëtimin e produkteve tipike
- Bizneset e zonës
- rreth 250 vizitorë pjesmarrës në festë

### **Programi i Aktiviteteve:**

- Ngritja e grupit të punës
- Kontakt me pjesëmarrësit në bashkëpunim
- Realizimi i infrastrukturës në (marrje me qera set, tavolina, stola, aparate dhe pajisje teknike, makineri etj )
- Realizimi i materialeve promocionale (dizenjim dhe realizim fletëpalosjesh turistike për promovimin e Vithkuqit , baner )
- Realizimi i transportit (transporti i pjesëmarrësve vajtje-ardhje)
- Lajmërimi i qytetarëve



## BASHKIA KORÇË

- Kontakti dhe përgatitja
- Kontakti me bizneset dhe donatorët
- Promovim dhe marketing
- Realizimi i eventit

### **Risia dhe Qëndrueshmëria e projektit:**

Për të disatin vit rradhazi “Festa e Vithkuqit “zhvillohet dhe zgjeron aktivitetin e tij cdo vit e më shumë për pjesëmarrje më të lartë.

### **Rezultate:**

- Gjallërimi i jetës artistike dhe kulturore në fshatin e Vithkuqit
- Rritja e numrit të vizitorëve nga brenda dhe jashtë vendit
- Promovim i produkteve të rajonit
- Promovimi i zonave të fshatit dhe atraksioneve turistike

**Kostoja Totale: 301,600 Lekë**

**Institucioni Zbatues:** Bashkia Korçë

**Struktura Përgjegjëse:** Drejtoria e projekteve, integritet europian, koordinimit me donatorët dhe turizmit.

**Shënime:** Kjo festë zhvillohet në fshatin turistik të Vithkuqit.

**Titulli i Projektit:** Festa e Rakisë

**Kohëzgjatja:** Gusht/Shator 2020

### **Përshkrim i shkurtër i projektit:**

Boboshtica është një nga fshatrat më të famshëm në rajon për turizmin kulinar e që vizionohet nga të gjithë ne si destinacioni i shijes. Produkti identitar i Boboshticës është Rakia e Manit të Zi, e cila përmes ndërhyrjeve strategjike të Bashkisë Korçë synon të kthehet në një rrjet të vërtetë prodhimi dhe degustimi në zonën Boboshticë-Drenovë. Kjo pije alkoolike, e prodhuar nga fruta të ndryshme, ka krijuar emrin e vet edhe në fshatra të tjerë: Dardha dallohet për rakinë e famshme të kumbullës së egër të zier dy herë, Voskopoja dallohet për rakinë e prodhuar nga thana, Polena, është kthyer sot në punishten artizanale të rajonit për prodhimin e rakisë së rrushit, ndërsa Dvorani, nisur nga plantacionet e famshme të mollëve mbart potencial për të prodhuar rakinë e mollës, duke mundësuar kështu një diversifikim të nënprodukteve e duke iu bashkuar itinerarit rajonal të shijes.



## BASHKIA KORÇË

### Qëllimi:

Qëllimi i organizimit të këtij projekti është nxitja dhe promovimi i produkteve të rajonit nëpërmjet aktiviteteve të cilat synojmë të tërheqim numër të madh vendasish dhe të huaj.

### Objektiva:

- Promovimi i produkteve të rajonit
- Rritja e numrit të frekuentimit të zonave përreth Korçës.
- Gjallërimi i jetës sociale dhe kulturore
- Zhvillimi i ekonomisë lokale tek kjo zonë

### Përfituesit /Treguesit

- 30 % e komunitetit ( femra dhe meshkuj) pjesmarrës aktivë në organizimin e Festës së Rakisë
- mbi 10% e grave pjesmarrëse në panairin e kulinarisë që do të realizohet gjatë festës, me qëllim promovimin dhe tregëtimin e produkteve tipike
- 10 % e bizneseve të zonës
- Fermerët e zonës
- rreth 300 vizitorë pjesmarrës në Festën e Rakisë

### Programi i Aktiviteteve:

- Ngritja e grupit të punës që do të realizojë Festën e Rakisë
- Dekor i veçantë tek sheshi ku do të zhvillohet Festa (*Dekori Festiv i parashikuar si zë në buxhetin e festës do të përdoret për krijimin e elementëve të ndryshëm dekorativë si elementë ndriçimi, struktura metalike ose druri të ndriçuara, printime në forex etj. Grupi i punës specifikon detajet e dekorit festiv 45 ditë përpara procedurës së prokurimit*)
- Vizitë tek familjet ne Boboshticë për të parë nga afër si prodhohet Rakia e Manit
- Markimi i bizneseve të cilat do të marrin pjesë në Festën e Rakisë
- Koncert festiv me serenata
- Panairi i produkteve tipike korçare, duke synuar promovimin e produkteve të zonës së Korçës.
- Realizmi i materialeve promocionale (*çanta letre të riciklueshme për mbledhjen e mollëve, kapela dhe përparëse, fletpalosje, baner etj. Grupi i punës specifikon detajet e dekorit festiv 45 ditë përpara procedurës së prokurimit*)



## BASHKIA KORÇË

- Promovim e eventit në media dhe në rrjetet sociale
- Menaxhimi i eventit
- Realizmi i festës së rakisë

### **Risia dhe Qëndrueshmëria e projektit:**

Festa e Rakisë organizohet për të disatin vit radhazi duke shënuar rritje të numrit të vizitorëve që frekuentojnë festën, risi e këtij viti do të jetë promovimi i itinerarit të shijes.

### **Rezultate:**

- Rritje të numrit të vizitorëve vendas dhe të huaj
- Promovimi i produkteve tipike lokale
- Impakt direkt në rritjen e zhvillimit ekonomik
- Gjallërimi i jetës sociale dhe kulturore
- Përforcim i imazhit turistik të vendit

**Kostoja Totale: 368,000 Lekë**

**Institucioni Zbatues:** Bashkia Korçë

**Struktura Përgjegjëse:** Drejtoria e projekteve, Koordinimit me Donatorët dhe Turizmit

**Shënime:** Projekti do të implementohet nga Bashkia Korçë në bashkëpunim me banorët e Boboshticës.

**Titulli i Projektit:** Korça Motor Show

**Kohëzgjatja:** Gjatë vitit 2020

### **Përshkrim i shkurtër i projektit:**

Për të gjithë të apasionuarit e motorrave, Bashkia Korçë mundëson një ditë ndryshe nga rutina e përditshme e mbushur plot me emocione dhe spektakël duke prezantuar modele të ndryshme motorrash si dhe një festival “Rock” në qendër të qytetit .

### **Qëllimi:**

Zhvillimi i turizmit të aventurës në rajon si dhe promovimi i qytetit.

### **Objektiva:**

- Një risi ndryshe nga rutina e përditshme
- Zhvillimi i turizmit të aventurës
- Zhvillimi i ekonomise lokale



## BASHKIA KORÇË

- Gjallërimi i jetës sociale dhe kulturore

### **Përfituesit/ Treguesit**

- mbi 500 pjesmarrës në festë
- mbi 10 biznese pjesmarrëse dhe bashkë organizues në aktivitet
- Vizitorët vendas dhe të huaj
- Bizneset lokale( Hotel/bujtina/ bare/ restorante) që përfitojnë direkt në rritjen e ekonomisë

### **Programi i Aktiviteteve:**

- Ngritja e grupit të punës
- Përgatitja e materialeve promociionale (baner)
- Realizimi i infrastrukturës (marrje me qera set tavolina, stola etj)
- Lajmërimi i pjesëmarrësve
- Kontakti dhe përgatitja e Show-t
- Promovimi i eventit në media dhe rrjete sociale
- Realizimi i eventit

### **Risia dhe Qëndrueshmëria e projektit:**

Korça Motor Shoë zhvillohet për të dytin vit rradhazi duke shënuar rritje të numrit të vizitorëve dhe pjesëmarrësve në aktivitet .

### **Rezultate:**

- Pjesëmarrje e lartë nga viti i kaluar
- Promovim si një qytet i pasuruar me aktivitetet dhe spektakël
- Frekuentues nga jashtë

**Kostoja Totale: 192 000 Lekë**

**Institucioni Zbatues:** Bashkia Korçë

**Struktura Përgjegjëse:** Drejtoria e projekteve, integritit europian, koordinimit me donatorët dhe turizmit.

**Titulli i Projektit:** Ditët Lokale

**Kohëzgjatja:** Gjatë vitit 2020

**Përshkrim i shkurtër i projektit:**



## BASHKIA KORÇË

Bashkia e qytetit të Korçës ka hartuar disa projekte, me qëllim gjallërimin e jetës së qytetit si dhe rizgjimimin dhe promovimin e vlerave të qytetit, duke e bërë atë sa më atraktiv për turistët vendas dhe të huaj. Risi e këtij vitit është organizimi i ditëve lokale në çdo fshat duke promovuar vlerat e trashëguara kulturore të secilës krahinë, duke i kthyer këto zona në atraksione turistike të qytetarëve vendas dhe të huaj. Ditët lokale do të organizohen në fshatrat Drenovë, Mborje, Kamenicë, Turan, Çiflik nëpërmjet të cilave do të promovohet tradita, vlerat artizanale dhe kulinaria. Duke besuar në suksesin e këtij projekti, synojmë përsëritjen e tij cdo vit duke e pasuruar gjithnjë me të tjerë elemente.

### **Qëllimi:**

Qëllimi i organizimit të këtij projekti është nxitja dhe promovimi i produkteve të rajonit, nëpërmjet aktiviteteve të cilat tërheqin numër të madh vendasish dhe të huaj.

### **Objektiva:**

- Promovimi i produkteve të rajonit
- Rritja e numrit të frekuentimit të zonave përreth Korçës.
- Gjallërimi i jetës sociale dhe kulturore
- Zhvillimi i ekonomisë lokale tek kjo zonë
- Promovim i traditës dhe vlerave artizanale të çdo fshati
- Kthimi i këtyre fshatrave në atraksione turistike

### **Përfituesit/ Treguesit**

- 30 % e komunitetit ( femra dhe meshkuj) pjesmarrës aktivë në organizimin e ditëve lokale
- mbi 15% e grave pjesmarrëse në panairin e kulinarisë dhe artizanatit që do të realizohet gjatë ditëve lokale, me qëllim promovimin dhe tregëtimin e produkteve tipike
- 10 % e bizneseve të zonës
- Fermerët e zonës
- rreth 2000 vizitorë pjesmarrës në ditët lokale

### **Programi i Aktiviteteve:**

- Hartimi i kalendarit festiv të Ditëve Lokale
- Ngritja e grupit të punës i cili do të ndjekë nga afër realizimin e Ditëve Lokale



## BASHKIA KORÇË

- Ngritja e infrastrukturës së nevojshme (*marrje me qera sete tavolina dhe stola, si dhe pajisje dhe aparate të tjera të nevojshme për realizimin e eventit*)
- Evidentim dhe markimi i bizneseve lokale të cilat do të marrin pjesë në event
- Realizimi i materialeve (*fletëpalosje, baner etj*)
- Promovim i ditëve lokale
- Menaxhimi dhe realizimi i ditëve lokale

### Risia dhe Qëndrueshmëria e projektit:

Synojmë që këto fshatra t'i kthejmë në atraksione turistike përmes promovimit të produkteve lokale.

### Rezultate:

- Promovimi i produkteve tipike lokale
- Impakt direkt në rritjen e zhvillimit ekonomik
- Gjallërimi i jetës sociale dhe kulturore
- Përf forcim i imazhit turistik të vendit

### Kostoja Totale:

Ditët Lokale			
Fshati	Dita	Datë	Kosto(në Lekë)
Drenovë	<i>Dita e Drenovës</i>	21 Maj	191,400
Mborje	<i>Dita e Mborjes</i>	30 Qershor	193,000
Kamenicë	<i>Dita e Kamenicës</i>	6 maj	125,000
Turan	<i>Dita e Turanit</i>	22 Mars	191,400
Çiflig	<i>Dita e Çifligut</i>	Prill	193,000

**Institucioni Zbatues:** Bashkia Korçë

**Struktura Përgjegjëse:** Drejtoria e projekteve, Koordinimit me Donatorët dhe Turizmit

**Shënime:** Projekti do të implementohet nga Bashkia Korçë në bashkëpunim me fermerët dhe bizneset e zonës.

**Titulli i Projektit:** Ditët e Petkave

**Kohëzgjatja:** 16 Gusht- 31 Gusht 2020

**Përshkrim i shkurtër i projektit:** Qyteti i Korçës është dalluar gjithmonë për gastronominë e veçantë e të pasur, po aq sa edhe për kulturën. Kulinaria korçare është pasuruar nga viti në vit me elementë të shumtë orientalë duke bërë që shumë gatime tipike të Korçës të mos njihen si duhet. Sot me rritjen e numrit të turistëve dhe iniciativave sipërmarrëse në fushën e turizmit, është kthyer



## BASHKIA KORÇË

vëmendja tek tradita gastronomike korçare me qëllimin njohjen e vizitorëve të huaj dhe vendas, që zgjedhin të qëndrojnë në Korçë për gatimet tipike të zonës. Për këtë arsye, Bashkia Korçë do të organizojë në fshatin Boboshticë, Njësia Administrative Drenovë, aktivitetin “Ditët e Pekave”, gjatë të cilave amvisat korçare do të demonstronjë për të gjithë pjesëmarrësit mënyrën e gatimit të petkave dhe ruajtjen e transmetimin e kësaj tradite tek brezat e rinj.

### **Qëllimi:**

- Promovimi dhe ruajtja e traditave të përgatitjes së zajreve tipike korçare dhe tërheqja e vizitorëve përmes zhvillimit të turizmit kulinar.

### **Objektiva:**

1. Ruajtja e traditave të gastronomisë të trashëguara nga e kaluara.
2. Vendosja e standartit të përgatitjes së produkteve tipike korçare, të cilat do të logohen “Made in Korça” dhe do të tregëtohen për të gjithë vizitorët që vizitojnë Korçën
3. Realizimi i një broshure, e cila përmend gatimet tipike korçare, e cila t’ju shpërndalet gjithë vizitorëve vendas dhe të huaj për t’u njohur me gatimet tradicionale të zonës së Korçës.

### **Përfituesit / Treguesit**

- 20 gra/ amvisa të cilat përfshihen direkt në organizimin dhe zhvillimin e zajreve tipike korçare
- Ditët e Petkave është aktivitet që do të ndikojë pozitivisht në rritjen dhe zhvillimin ekonomik të zonës duke iniciuar krijimin e sipërmarrjeve individuale të 20 grave pjesëmarrëse në festë
- Mbi 50 bizneset lokale të cilët do të jenë pjesë e guidës " Shije Korçe"
- Mbi 500 vizitorë ( qytetarë vendas dhe të huaj) të cilët do të kenë mundësinë të blenë produktet tipike korçare.

### **Programi i Aktiviteteve:**

1. Bashkëpunim me të gjitha amvisat e Korçës dhe zonave turistike përreth Korçës, të cilat kanë njohuri për të përgatitur petkat dhe për të demonstruar mënyrën e gatimit të tyre.
2. Përgatitja e procedurave për realizimin e zërave të projektit.
3. Konceptimi i materialeve promociionale të aktivitetit, konkretisht do të përgatiten set kapele dhe përparëse me logon e aktivitetit, të cilat do ju shpërndahen amvisave pjesëmarrëse në aktivitet. Gjithashtu, me qëllim promovimin e gatimeve tradicionale do të publikohet “Guida e Shijes” në 2 gjuhë shqip dhe anglisht për të gjithë vizitorët vendas dhe të huaj, do të realizohet baner me emrin



## BASHKIA KORÇË

dhe datat e e aktivitetit, si edhe 50 copë çanta prej letre për të vendosur petkat që do të tregëtohen nga pjesëmarrësit.

4. Përgatitja e dokumentacionit përmbyllës për realizimin e projektit (relacion, foto nga aktiviteti).

**Risia dhe Qëndrueshmëria e projektit:** Projekti “Ditët e Petkave”, implementohet për herë të parë nga Bashkia Korçë dhe do të vijojë të zbatohet edhe në vitet në vazhdim për t’u kthyer në një traditë të përvitshme, duke tërhequr akoma më tepër vëmendjen e vizitorëve të huaj, të cilët vetëm kanë dëgjuar në lidhje me këtë produkt tradicional dhe në këtë aktivitet ata kanë mundësi të shohin nga afër përgatitjen e petkave dhe të shijojnë këtë produkt tipik korçar, të cilën banorët e përdorin si ushqim tradicional gjatë periudhës së dimrit.

**Rezultatet:** Promovimi i traditës së gatimeve tradicionale të Korçës dhe standartizimi i produkteve lokale të prodhuara vetëm në Korçë, të cilat nën logon “Made in Korça”, do të përbëjnë një produkt tipik korçar e cila do të tërheqë vëmendjen e vizitorëve vendas dhe të huaj dhe do të jetë një arsye më shumë për të vizituar Korçën.

**Kostoja Totale: 340.000 Lekë**

**Institucioni Zbatues:** Bashkia Korçë

**Struktura Përgjegjëse:** Drejtoria e Projekteve, Integritimit Europian, Koordinimit me Donatorët dhe Turizmit

**Shënime:** Projekti zbatohet gjatë muajit Gusht 2020, duke qënë se ky muaj shënon edhe një numër tepër të lartë të turistëve që frekuentojnë Korçën, me qëllim që shumë prej tyre të kenë mundësi të shohin nga afër përgatitjen e petkave, një produkti tipik korçar.

**Titulli i Projektit:** Ditët e Luleve

**Kohëzgjatja:** Prill- Maj 2020

**Përshkrim i shkurtër i projektit:** Bashkia e Korçës gjatë muajit Prill- Maj organizon çdo vit Panairin e Pranverës. Duke qënë se Korça dallohet për traditën e dekorimit të oborreve të shtëpive dhe pallateve me lule shumëngjyrëshe, Bashkia ka vendosur që këtë vit të çelë pranverën me një panair lulesh, të organizuar në Zonën Pedonale të qytetit. Përveç panairit të luleve nuk do të mungojnë edhe aktivitetet për fëmijë, ndërkohë që edhe dekori i veçantë që lidhet me pranverën e bën Korçën shumë të dashur dhe atraktive për të gjithë turistët që e vizitojnë.



## BASHKIA KORÇË

**Qëllimi:** Promovimi i traditës së hershme të qytetit për kultivimin e luleve përmes shfaqjes së trashëgimisë tonë shpirtërore, vlerave tradicionale të zonës.

### **Objektiva:**

1. Gjallërimi i jetës përmes zhvillimit të aktiviteteve të veçanta në qytet
2. Promovimi i bizneseve lokale të cilat promovojnë dhe tregëtojnë lule.
3. Ruajtja e traditës së përkujdesit për lulet dhe transmetimi i kësaj traditë tek brezat e rinj.

### **Përfituesit/ Treguesit**

- 10 gra sipërmarrëse në sektorin e luleve
- Qytetarët e Korçës
- Bizneset e zonës këmbësore

### **Programi i Aktiviteteve:**

1. Përgatitja e procedurave për realizimin e zërave të projektit.
2. Konceptimi për realizimin e materialeve promocionale, konkretisht përgatitja e një baneri që do të vendoset në ambientet ku do të zhvillohet aktiviteti.
3. Kontakte me dyqanet që tregëtojnë lule për të marrë pjesë në panair dhe për të promovuar lloje të veçanta lulesh.
4. Organizimi me nxënësit e shkollave të sistemit parauniversitar, me të cilët do të organizohen aktivitete të ndryshme.
5. Realizimi i aktivitetit “Ditët e Luleve”
6. Përgatitja e dokumentacionit përmblyllës për realizimin e projektit (relacion, foto nga aktiviteti).

**Risia dhe Qëndrueshmëria e projektit:** Projekti zbatohet për herë të dytë këtë vit dhe ka treguar interes dhe sukses të plotë vitin e kaluar për të gjithë banorët e Korçës, por edhe për vizitorët vendas dhe të huaj. Këtë vit është menduar që përveç llojeve të ndryshme të luleve, të ekspozohen për t'i parë nga afër edhe një shumëllojshmëri zogjsh për të gjithë dashamirësit e zogjve.

**Rezultatet:** Promovimi i shumëllojshmërisë së luleve që qyteti ynë kultivon dhe kthimi i aktivitetit në një traditë të përvitshme, e cila ka për qëllim të ndikojë drejtpërdrejt në nxitjen e turizmit kulturor, argëtimin e banorëve dhe ruajtjen e traditës së përkujdesit ndaj luleve.

**Kostoja Totale: 66.400 Lekë**

**Institucioni Zbatues:** Bashkia Korçë



## BASHKIA KORÇË

**Struktura Përgjegjëse:** Drejtoria e Projekteve, Integritimit Europian, Koordinimit me Donatorët dhe Turizmit

**Titulli i Projektit:** Festa e Dardhës

**Kohëzgjatja:** 16 Gusht 2020

### **Përshkrim i shkurtër i projektit:**

Fshati i Dardhës, është një oaz ekuilibri mes sistemit natyror dhe atij të ndërtuar, që ka të vetmen pistë skish në nivel kombëtar në Shqipëri, e që sot tërheq vizitorë, jo vetëm të turizmit dimëror, por edhe atij rekreativ. Një vendbanim, me një karakter disi të ndryshëm nga konteksti rural shqiptar, me një qëndrim deri diku të padepërtueshëm, por që mund ta njohësh shumë thjesht përmes metodologjisë së psikogjeografisë. Përmes këtij mjeti, ne zgjodhëm të eksplorojmë mjedisin e ndërtuar të Dardhës, për të hyrë në thellësi të shpirtit të këtij fshati, e për të kuptuar ADN-në e tij dhe memorien gjenetike, që ende pulson në integritetin e këtij ansambli socio-fizik.

### **Qëllimi:**

Qëllimi i organizimit të këtij projekti është nxitja dhe promovimi i produkteve të rajonit, nëpërmjet aktiviteteve të cilat tërheqin numër të madh vendasish dhe të huaj.

### **Objektiva:**

- Promovimi i produkteve të rajonit
- Rritja e numrit të frekuentimit të zonave përreth Korçës.
- Gjallërimi i jetës sociale dhe kulturore
- Zhvillimi i ekonomisë lokale tek kjo zonë

### **Përfituesit/ Treguesit**

- 10 % e amvisave të zonës që do të jenë bashkë organizatore në realizimin e festës ( në përgatitjen e panairit të produkteve lokale)
- Banorët e fshatit turistik Dardhë
- Qytetarët vendas dhe të huaj
- Bizneset lokale të zonës

### **Programi i Aktiviteteve:**

- Ngritja e grupit të punë që do të realizojë Festën e Dardhës në datë 16 Gusht 2020
- Dekor i veçantë tek sheshi qëndror ku do të zhvillohet Festa ( *Dekori Festiv i parashikuar si zë në buxhetin e festës do të përdoret për krijimin e elementëve të ndryshëm dekorativë si elementë ndriçimi, struktura metalike ose druri të ndriçuara, printime në forex etj. Grupi i punës specifikon detajet e dekorit festiv 45 ditë përpara procedurës tenderike*)



## BASHKIA KORÇË

### **- Identifikimi i grave sipërmarrëse për realizimin e panairit të produkteve lokale**

- Markimi i bizneseve të cilat do të marrin pjesë në Festë
- Koncert festiv
- Realizmi i materialeve promociionale (*fletpalosje, baner etj*)
- Promovim e eventit
- Menaxhimi i eventit
- Realizmi i festës së mollës

### **Risia dhe Qëndrueshmëria e projektit:**

Festa e Dardhës organizohet për të disatin vit radhazi duke shënuar rritje të bizneseve agropërpunuese pjesmarrëse. Synojmë që këtë vit Festën e Dardhës ta kthejmë në një magnet për tregëtimin e produkteve lokale.

### **Rezultate:**

- Rritje të numrit të vizitorëve vendas dhe të huaj
- Promovimi i produkteve tipike lokale
- Impakt direkt në rritjen e zhvillimit ekonomik
- Gjallërimi i jetës sociale dhe kulturore
- Përforcim i imazhit turistik të vendit

**Kostoja Totale: 371,400 Lekë**

**Institucioni Zbatues:** Bashkia Korçë

**Struktura Përgjegjëse:** Drejtoria e projekteve, Koordinimit me Donatorët dhe Turizmit

**Titulli i Projektit: Festivali i Vjeshtës**

**Kohëzgjatja: Shtator – Tetor 2020**

### **Përshkrim i shkurtër i projektit:**

Festivali i vjeshtës një tjetër event që i bashkohet qytetit të Korçës gjatë periudhës së vjeshtës i cili konsiston një numër të madh aktivitetesh kulturore, artistike dhe tradicionale për të përçar vlerat që ky qytet mbart .

Përveç dekorit specifik dhe të personalizuar me mjeshtëri nga stafi i Bashkisë, veçantia e këtij festivali do të shoqërohet dhe me praninë e këngëtarëve të mirënjohur të cilët do të performojnë në skenat e Pazarit të Vjetër dhe në zonën kryesore të qytetit .

### **Qëllimi:**

Vazhdimësia dhe kthimi i këtij eventit në një traditë kulturore për qytetin e Korçës.



## BASHKIA KORÇË

### **Objektiva:**

1. Gjallërimi dhe pasurimi i jetës social-kulturore në qytet
2. Promovimi i qytetit si një atraksion turistik i mbushur me aktivitete kulturore
3. Frekuentimi dhe rritja e të ardhurave të bizneseve që lidhen direkt/indirekt me turizmin (bare, restorante, hotele etj )
4. Synimi për të rritur numrin e turistëve jashtë dhe brenda vendit

### **Përfituesit/ Treguesit**

- mbi 350 pjesëmarrës gjatë festivalit
- mbi 10 biznese pjesmarrëse dhe bashkë organizues në festën
- mbi 5 këngëtarë dhe grupe artistike që performojnë gjatë festivalit
- të gjithë qytetarët e Korçës dhe rajonit janë pjesmarrës gjatë festës
- Bizneset lokale ( Hotel/bujtina/ bare/ restorante) që përfitojnë direkt në rritjen e ekonomisë

### **Programi i Aktiviteteve:**

1. Ngritja e grupit të punës
2. Përgatitja e materialeve promociionale (baner, fletëpalosje, forex)
3. Realizimi i infrastrukturës (pajisje teknike , marrje me qera etj )
4. Lajmërimi i pjesëmarrësve
5. Kontakti dhe përgatitja e Show-it
6. Kontakti i mundshëm me biznese dhe donatorë
7. Promovimi i eventit
8. Realizimi i eventit

### **Risia dhe Qëndrueshmëria e projektit:**

Festivali i vjeshtës synon për vitet e ardhshme një numër më të lartë pjesëmarrjeje dhe një aktivitet më të zgjeruar.

### **Rezultate:**

- Frekuentues nga të gjitha moshat të aktiviteteve të organizuara nga Bashkia
- Rritja e turizmit dhe të ardhurave në biznes
- Promovimi i Korçës si një qytet i mbushur me aktivitete

**Kostoja Totale: 200,000 Lekë**

**Institucioni Zbatues:** Bashkia Korçë

**Struktura Përgjegjëse:** Drejtoria e Projekteve, Integrimin europian, Koordinimit me Donatorët dhe Turizmit.



## BASHKIA KORÇË

### **7.12. Fondi rezervë 04910**

#### **Njësia shpenzuese: Bashkia**

Për vitin 2020 fondi i planifikuar është në vlerën 2,000 mijë lekë.

Fondi rezervë do të përdoret vetëm për rastet e financimit të shpenzimeve të paparashikuara, të cilat nuk njihen dhe janë të pamundura të parashikohen gjatë procesit të përgatitjes së buxhetit. Buxheti vendor përfshin një fond rezervë, të pashpërndarë, i cili miratohet nga këshilli bashkiak në buxhetin vjetor të bashkisë deri në masën 3 për qind të vlerës së përgjithshme të fondeve të miratuara, përjashtuar transfertat e kushtëzuara.

### **7.13. Fondi i kontigjencës 04940**

#### **Njësia shpenzuese: Bashkia**

Për vitin 2020 fondi i planifikuar është në vlerën 1,000 mijë lekë.

Buxheti vendor përfshin një fond kontigjence, të pashpërndarë, i cili miratohet nga këshilli bashkiak në buxhetin vjetor të bashkisë deri në masën 3 për qind të vlerës së përgjithshme të fondeve të miratuara, përjashtuar transfertat e kushtëzuara. Fondi i kontigjencës është fondi i pashpërndarë, që krijohet për të mbuluar risqet e mundshme, për të ardhurat dhe shpenzimet, gjatë zbatimit të buxhetit. Gjithashtu fondi i kontigjencës krijohet për të përballuar edhe efektet e mosrealizimit të të ardhurave dhe efektet e paparashikuara të normave të interesit.

Menaxhimi i mbetjeve 051

### **7.14. Programi: Menaxhimi i mbetjeve 05100**

#### **Burimi i financimit: Transferta e pakushtëzuar dhe të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore** **Njësia shpenzuese: Bashkia**

Buxheti i këtij program është në vlerën 124,807 mijë lekë i detajuar si më poshtë:

- shpenzime personeli në vlerën 630 mijë lekësh
- shpenzime korrente në vlerën 124,177 mijë lekë
- Fondi i planifikuar për paga për supervisorin e pastrimit është 540 mijë lekë në të njëjtin nivel me vitin 2019.



## BASHKIA KORÇË

- Fondi i planifikuar për sigurime shoqërore dhe shëndetësore për supervizorin e pastrimit është 90 mijë lekë.
- Fondi i planifikuar për shërbimin e pastrimit të qytetit sipas kontratës do të jetë në vlerën 79,618 mijë lekë.

Shërbimi i pastrimit është një nga shërbimet më të rëndësishme që kryen Bashkia në komunitet. Ky shërbim kryhet nëpërmjet kontraktimit me palë të treta brenda qytetit dhe për grumbullimin dhe transportin e mbeturinave të fshatrave.

Në buxhetin e vitit 2020 sipas vlerës së kontratës kërkohet shuma **79,618 mijë lekë**. Objekti i këtij **shërbimi është pastrimi i rrugëve** dhe trotuareve, evadimi i mbetjeve urbane në qytetin e Korçës dhe transportimi i tyre për në landfillin rajonal, lagia e rrugëve, evadimi i dëborës në stinën e dimrit dhe hedhja e kripës për lehtësimin e qarkullimit të automjeteve dhe njerëzve si dhe grumbullimi dhe evadimi i mbetjeve të fshatrave. Pastrimi i rrugëve bëhet çdo ditë prej orës 24.00 deri 06.00. Pastrohen çdo ditë 419.369 m<sup>2</sup> rrugë dhe trotuare dhe fshihen me fshesë mekanike 171.290m<sup>2</sup> në ditë. Transporti i mbeturinave për në landfill bëhet çdo ditë me mjete teknologjike prej orës 03.00 deri 07.00 për evadimin e mbetjeve nëpër konteniere dhe prej orës 07.00 deri 11.00 nëpër lagjet që nuk kanë konteniere. Çdo ditë do evadohen rreth 55 ton mbeturina duke përfshirë qytetin edhe fshatrat. Nga shtrirja e projektit për riciklimin që marrim në qese të veçanta letrën, plastikën, qelqin dhe aluminin në pesë lagje të qytetit dhe vendosja e 100 kazanëve jeshile në qytet dhe 50 nëpër fshatra me qëllim reduktimin e mbetjeve, kemi arritur në kursim të shpenzimeve. Lagia e rrugëve bëhet për periudhën 01.04 deri 31.10 cdo ditë nga ora 06.00 deri 18.00 në një sipërfaqe prej 188.208 m<sup>2</sup> si dhe larje speciale e rrugëve me sip. 67.508 m<sup>2</sup> çdo ditë. Grumbullimi i mbeturinave bëhet me rreth 450 konteniere në qytet cdo ditë dhe 150 konteniere në fshat që do të evadohen tre here në javë.

Në buxhetin e vitit 2020 do të planifikohet edhe vlera prej **3,500 mijë lekë** e cila do të përdoret **për shërbimin e menaxhimit të mbetjeve inerte të krijuara nga ndërtimet**. Nga përllogaritjet e kryera rezulton të dalin rreth 60,000 m<sup>3</sup> inerte.

Mbetjet çohen në landfillin sanitar rajonal të Maliqit i cili kërkon kosto shtesë prej 41,059 mijë lekë për funksionimin e landfillit.

Fondi i planifikuar tek transfertat për organizatat është **41,059 mijë lekë**, i cili është **kontribut i Bashkisë Korçë për KRWM** (pagesa fikse si aksioner i KRWM sha dhe pagesa mujore sipas faturave për mbetjet).

Mbrojtja e mjedisit 056



## BASHKIA KORÇË

### 7.15. Programi: Ndërgjegjësimi mjedisor 05630

#### Burimi i financimit: Transferta e pakushtëzuar si dhe të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore

#### Njësia shpenzuese: Bashkia

Programi mbulon veprimtaritë dhe politikat për mbrojtjen mjedisore.

Buxheti i planifikuar për këtë program është në vlerën 2,621 mijë lekë dhe nr. i punonjësve është 3.

- shpenzime personeli në vlerën 2,435 mijë lekësh
- shpenzime korrente në vlerën 186 mijë lekë

Fondi i planifikuar për paga për vitin 2020 është 2,100 mijë lekë.

Fondi i planifikuar për sigurime shoqërore dhe shëndetësore është për vitin 2020 është 335 mijë lekë.

Fondi i planifikuar për shpenzime operative për vitin 2020 në vlerën 186 mijë lekë.

Ky fond do të përdoret për realizimin e shpenzimeve operative në këtë program si dhe realizimin e shpenzimeve për projektet në fushën e mjedisit të detajuara si më poshtë:

000/lekë

Përshkrimi i shpenzimeve operative	PI 2019	Real 10 mujor	%	PI e real të prtish.2019	PI 2020	Dif PI20-PI19	Dif PI20-PI p 19
Sherbime te printimitit & publikimit	72	37	51%	72	56	(16)	(16)
Shpenzime pritje-percjellje	35	29	83%	35		(35)	(35)
Shpenzime te tjera	64	16	25%	60	50	(14)	(10)
Shpenzime udhetim I brendshem	140	123	88%	100	80	(60)	(20)
Shpenzime honorare	75		0%	75		(75)	(75)
<b>Total</b>	<b>386</b>	<b>205</b>	<b>53%</b>	<b>342</b>	<b>186</b>	<b>(200)</b>	<b>(156)</b>

#### Titulli i Projektit: Dita pa makina

Kohëzgjatja: 22 Shtator

#### Përshkrim i shkurtër i projektit:

Dita Ndërkombëtare pa Makina, synon sensibilizimin e njerëzve që të shmangin të paktën një ditë makinat e tyre, të cilat emetojnë lëndë të dëmshme për organizimin dhe si përpjekje për të kontribuar në mbrojtje të mjedisit dhe tu kujtojmë njerëzve se nuk duhet të pranojmë të bëhemi shoqëri e dominuar nga makinat dhe të vuajmë pasojat e shëndetit dhe cilësisë së jetës tonë. Çdo vit në 22



## BASHKIA KORÇË

shtator ,njerëzit nga e gjithë bota vende të ndryshme bashkohen dhe përdorin forma të ndryshme inkurajuese me një qëllim të përbashkët për të reduktuar numrin e automjeteve në qytet. Përfitimi i madh shoqëror është një ditë me sa më pak trafik, një ambient më të gjelbër, mushkëri më të pastra dhe reduktim të varësisë nga karburanti. Sot dita pa makina përfshin përkrahje nga 1500 qytete në 40 vende të botës. Në kuadër të kesaj dite Bashkia Korçë do të organizojë një pedalim ku pjesëmarrës do të jenë nxënës të shkollave 9-vjeçare dhe të mesme të qytetit.

### **Qëllimi:**

- Promovimi i vlerave dhe standarteve europiane për një pjesëmarrje më të gjerë të qytetarëve dhe të rinjve në përmirësimin e mjedisit, dhe cilësisë së ajrit për një jetë më të shëndetshme.

### **Objektiva:**

- Synojmë sensibilizimin e çdo qytetari, institucioni publik apo privat për të ndërmarrë veprime në mbrojtje të mjedisit.
- Rritje të pjesëmarrësve të grupmoshave të reja në ndërgjegjësimin për mbrojtjen e mjedisit.
- Shmangien e makinave që emetojnë lëndë të dëmshme dhe inkurajim për përdorim të biçikletave.

### **Përfituesit/ Treguesit**

- Mbi 150 nxënës të shkollave 9-vjeçare dhe të mesme do të jenë pjesë e pedalimit
- Qytetarët vendas dhe të huaj pjesë e sensibilizimit qytetar
- Shoqata e çiklistëve korçarë

### **Programi i Aktiviteteve:**

- Ngritja e grupit të punës
- Lajmërimi i të gjitha shkollave 9-vjeçare dhe të mesme për aktivitetin e qytetit ( në bashkëpunim me Drejtorinë Rajonale Arsimore)
- Realizimi i materialeve promicionale (*bluza, kapele, banner, etj*)
- Lajmërimi i qytetarëve
- Promovimi dhe marketim i eventit
- Realizimi i aktivitetit



## BASHKIA KORÇË

### **Risia dhe Qëndrueshmëria e projektit:**

Dita pa makina organizohet për të tretin vit rradhazi nga Bashkia e Korces, risi e këtij viti është përfshirja e të rinjve nga shkollat 9-vjeçare dhe të mesme të qytetit.

### **Rezultate:**

- Sensibilizimi i të rinjve dhe qytetarëve për tu bërë pjesë e aktiviteteve sociale
- Rritje e pjesëmarrësve nga të gjitha grupmoshat për ndërgjegjësimin e mbrojtjes të mjedisit.

**Kostoja Totale: 55,600 Lekë**

**Institucioni Zbatues:** Bashkia Korçë

**Struktura Përgjegjëse:** Drejtoria e Projekteve, Koordinimit me donatorët dhe Turizmit

**Shënime:** Aktiviteti do të zhvillohet nga Bashkia Korçë në bashkëpunim me Drejtorinë Rajonale Arsimore, Korçë.

Urbanistika 061

### **7.16. Programi: Planifikimi urban vendor 06140**

**Burimi i financimit: Transferta e pakushtëzuar dhe të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore**

**Njësia shpenzuese: Bashkia Korçë**

Ky program përfshin zhvillimin, përditësimin, bashkërendimin dhe monitorimin e planeve të zhvillimit urbanistik. Lëshimin e lejeve për ndërtime të reja, zhvillimin e tokës dhe veprimtari të tjera që ndikojnë në urbanistikën e njësisë së vetëqeverisjes vendore. Planifikim i përgjithshëm, duke përfshirë formulimin, përditësimin, bashkërendimin dhe monitorimin e Planeve të Përgjithshme Vendore/Planeve të Zhvillimit Strategjik si dhe hartimin e planeve të zonimit dhe të rregullave të ndërtimit.

Buxheti i këtij program është në vlerën 33,091 mijë lekë dhe nr. i punonjësve është 13, i detajuar si më poshtë:

- shpenzime personeli në vlerën 9,000 mijë lekë
- shpenzime korrente në vlerën 4,791 mijë lekë
- shpenzime për hartim projektesh dhe oponenca teknike në vlerën 19,300 mijë lekë

Fondi i planifikuar për paga për këtë program është 7,700 mijë lekë.

Fondi i planifikuar për sigurime shoqërore dhe shëndetësore është 1,300 mijë lekë.

Fondi i planifikuar për shpenzime operative është në vlerën 4,791 mijë lekë të detajuara si më poshtë:  
000/lekë



## BASHKIA KORÇË

Programi	Institucioni	Përshkrimi i shpenzimeve operative	PI 2019	Real 10 mujor	%	PI e real të pritsh 2019	PI 2020	Dif PI20-PI19	Dif PI20-PI p 19
Planifikimi Urban Vendor	Bashkia	Sherbime postare	116	116	100%	116	300	184	184
Planifikimi Urban Vendor	Bashkia	Abonim internet ADSL dhe Central Telefonik	52	52	100%	52	60	8	8
Planifikimi Urban Vendor	Bashkia	Energjia elektrike Bashki	1,012	705	70%	1,000	955	(57)	(45)
Planifikimi Urban Vendor	Bashkia	Pagese e konsumit te ujit	65	65	100%	65	92	27	27
Planifikimi Urban Vendor	Bashkia	TVMP dhe SGS					47	47	47
Planifikimi Urban Vendor	Bashkia	Shpenzime udhetime brenda dhe jashte dhe dieta	235	85	36%	235	250	15	15
Planifikimi Urban Vendor	Bashkia	Karburant					807	807	807
Planifikimi Urban Vendor	Bashkia	Leter shkrimi fotokopimi Kancelari	88	88	100%	88	135	47	47
Planifikimi Urban Vendor	Bashkia	Materiale konsumi	27	27	100%	27	25	(2)	(2)
Planifikimi Urban Vendor	Bashkia	Riparim fotokopje dhe pajisje te ndryshme	70		0%	70	60	(10)	(10)
Planifikimi Urban Vendor	Bashkia	Boje printeri e fotokopjues	100	100	100%	100	215	115	115
Planifikimi Urban Vendor	Bashkia	Riparim paisje makinash					123	123	123
Planifikimi Urban Vendor	Bashkia	Siguracion makine					25	25	25
Planifikimi Urban Vendor	Bashkia	Aplikim ne Ministrine e Mjedisit per miratim VNM	300	30	10%	200	300	-	100
Planifikimi Urban Vendor	Bashkia	Mirembajtje e "Platformes WEB GIS"	600		0%		1397	797	1,397
<b>TOTAL</b>			<b>2,665</b>	<b>1,268</b>	<b>48%</b>	<b>1,953</b>	<b>4,791</b>	<b>2,126</b>	<b>2,838</b>

Fondi i planifikuar për hartim projektsh dhe oponenca teknike është në vlerën 19,300 mijë lekë.

Detajimi i këtyre fondeve do të bëhet me urdhër të Kryetarit të Bashkisë.

Zhvillimi i komunitetit 062

### 7.17. Programi: Shërbime publike vendore 06260

**Burimi i financimit: Transferta e pakushtëzuar dhe të ardhurat nga taksat dhe tarifrat vendore**

**Njësia shpenzuese: Bashkia Korçë**



## BASHKIA KORÇË

Ky program përfshin ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e varrezave publike dhe të dëshmorëve, si dhe garantimin e shërbimit publik të varrimit.

Buxheti i planifikuar për këtë program për vitin 2020 është në vlerën 5,030 mijë lekë dhe nr. i punonjësve është 1, i detajuar si më poshtë:

- shpenzime personeli në vlerën 530 mijë lekë
- shpenzime korrente në vlerën 4,500 mijë lekë

Fondi i planifikuar për paga për mbikqyrësin e shërbimit të Mirmbajtjes së varrezave publike dhe të dëshmorëve është 454 mijë lekë.

Fondi i planifikuar për sigurime shoqërore dhe shëndetësore për mbikqyrësin e shërbimit të Mirmbajtjes së varrezave publike dhe të dëshmorëve është 76 mijë lekë.

Fondi i planifikuar për shërbimin e Mirmbajtjes së varrezave publike dhe të dëshmorëve është 4,500 mijë lekë sipas kontratës.

Ky shërbim kryhet nga shoqëria “Korsel”sh.p.k .Kontrata e shërbimit aktuale ka afat deri në Korrik 2020.

Vlera e këtij shërbimi për vitin 2020 do të planifikohet në vlerën **4.500.000 lekë**, me qëllim shtrirjen e shërbimit dhe në varrezat e reja. Ky shërbim konsiston në zërat e mëposhtëm:

- a. Pastrim parcelash, rrugë dhe sheshe të brendshme ndërmjet blloqeve të varrimit
- b. Mirëmbajtje drurë dhe shkurre dekorative
- c. Mbjellje drurë dekorative
- d. Kositje, grumbullim dhe transport bari
- e. Mirëmbajtje bordure betoni të brendshme
- f. Lyerje me gëlqere të bordurave dhe pemëve në varrezat publike dhe të dëshmorëve
- g. Ruajtja e objektit në varrezat publike dhe të dëshmorëve
- h. Mirëmbajtje e varrezave të dëshmorëve
- i. Mirëmbajtje e varrezave të dëshmorëve nga amortizimi
- j. Konsumi i ujit të pijshëm për mirëmbajtje dhe nevojat e qytetarëve

Shërbimet rekreative dhe sportive 081

### **7.18. Programi: Sport dhe argëtim 08130**

**Burimi i financimit: Transferta e pakushtëzuar dhe të ardhurat nga taksat dhe tarifatat vendore**



## BASHKIA KORÇË

### Njësia shpenzuese Bashkia Korçë

Ky program përfshin organizimin e aktiviteteve sportive, çlodhëse e argëtuese.

Buxheti i këtij program është në vlerën 65,469 mijë lekë i detajuar si më poshtë:

- shpenzime korrente në vlerën 65,469 mijë lekë

Fondi i planifikuar për shpenzime operative për realizimin e projekteve në këtë program është në vlerën 556 mijë lekë e detajuar si më poshtë:

000/lekë

Programi	Institucioni	Përshkrimi i shpenzimeve operative	Pl 2019	Real 10 mujor	%	Pl e real të pritsh 2019	Pl 2020	Dif Pl20-Pl 19	Dif Pl20-Pl p 19
Sport dhe argëtim	Bashkia	Sherbime te printimit & publikimit	7		0%	7	21	15	15
Sport dhe argëtim	Bashkia	Shpenzime qeramarje aparate dhe pajisje	25		0%	25		(25)	(25)
Sport dhe argëtim	Bashkia	Shpenzime te tjera	106		0%	106	112	6	6
Sport dhe argëtim	Bashkia	Shpenzime udhetimi brenda dhe jashte	540		0%	540	423	(117)	(117)
Sport dhe argëtim	Bashkia	Shpenzime honorare	285		0%	285		(285)	(285)
Sport dhe argëtim	Bashkia	Shpenzime për ujë	50	44	88%	44		(50)	(44)
Sport dhe argëtim	Bashkia	Shpenzime telefonike	3	3	100%	3		(3)	(3)
Sport dhe argëtim	Bashkia	Energjia elektrike	120	113	94%	113		(120)	(113)
<b>TOTAL</b>			<b>1,136</b>	<b>160</b>	<b>14%</b>	<b>1,123</b>	<b>556</b>	<b>(580)</b>	<b>(567)</b>

### Projektet në sport dhe argëtim

Emertimi i Projektit	Programi	Sherbime	Udhetim	Shp te tjera	TOTALI
		te print & publikimit	i brendshem	sh.operativ	
		6022010	6024100	6029099	
Tenis per te gjithë	Sport dhe Argetim	21,200	62,500	112,000	195,700
Korça open air	Sport dhe Argetim		360,000		360,000
<b>Total prog sport dhe argetim</b>		<b>21,200</b>	<b>422,500</b>	<b>112,000</b>	<b>555,700</b>

**Titulli i Projektit: Tenis për të gjithë**

**Kohëzgjatja: Gjatë vitit 2020**

**Përshkrim i shkurtër i projektit:**



## BASHKIA KORÇË

Korça një qytet ku tenisi është luajtur më shumë se 100 vjet më parë duket se do të ketë një hap të madh cilësor në një kohë të shkurtër pas përfundimit të investimit të qendrës më të madhe në Shqipëri me infrastrukturën më moderne sportive dhe me ambiente argëtuese, i cili i sjell qytetit modelin më unik të transformimit të hapësirave publike si dhe realizimin e turneut të tij. Me pjesëmarrjen e sportistëve nga e gjithë Shqipëria, të të gjitha grupmoshave amatore ose profesionistë ky aktivitet do të rritë frekuentimin dhe promovimin e kësaj qendre .

### **Qëllimi:**

Rikthimi dhe masivimi i sportit të tenisit në qytetin e Korçës sidomos tek të rinjtë dhe rivitalizimi i Qendrës Sportive.

### **Objektiva:**

- Pjesëmarrja e të gjithë qytetarëve duke përfshirë të gjitha grupmoshat
- Vazhdimi i traditës dhe kulturës për sportin
- Masivizimi i sportit të tenisit dhe gjithëpërfshirja e të rinjve
- Angazhim të të rinjve në sport
- Rritje të numrit të pjesëmarrësve çdo vit

### **Përfituesit/ Treguesit**

- 150 fëmijë të grupmoshave të ndryshme që kanë pasion sportin e tenisit
- rritje të numrit të frekuentuesve të qytetit të fëmijëve dhe promovimi i qendrës multifunksionale sportive në nivel kombëtar
- rritje të numrit të fëmijëve që merren me sportin e tenisit

### **Programi i Aktiviteteve:**

- Ngritja e grupit të punës
- Lajmërimi i të gjithë të rinjve, shkollave 9-vjeçare dhe të mesme
- Realizimi i materialeve promocionale (baner, diploma, kupa, çertifikata, etj)
- Përgatitja e materialeve të nevojshme për kamiponatin (topa tenisi, fije për thurrje raketash, akomodimi i lojtarëve)
- Promovimi dhe marketingu i eventit
- Realizimi i aktivitetit



## BASHKIA KORÇË

### **Risia dhe Qëndrueshmëria e projektit:**

Kampionati i tenisit organizohet për të dytin vit rradhazi nga Bashkia e Korçës dhe vemë re se interesi i pjesëmarrjesve nga viti në vit vjen duke u rritur.

### **Rezultate:**

- Rritja e numrit të frekuentuesve të Qendrës Multifunktionale
- Angazhimi i të rinjve
- Perfaqësimi i qytetit të Korçës në aktivitete lokale dhe ndërkombëtare
- Numër i lartë pjesëmarrësish në sportin e tenisit.

**Kostoja Totale:** 195,700 Lekë

**Institucioni Zbatues:** Bashkia Korçë

**Struktura Përgjegjëse:** Drejtoria e Projekteve, Koordinimit me donatorët dhe Turizmit.

**Shënime:** Kampionati zhvillohet në bashkëpunim me Shoqatën e Tenistëve, Korçë.

**Titulli i Projektit:** Korça Open Air

**Kohëzgjatja:** Dhjetor 2020

### **Përshkrim i shkurtër i projektit:**

Bashkise Korçë në bashkëpunim me grupin e Aeronautikës Shqiptare organizon për të tretin vit rradhazi aktivitetin 3 ditor “Korca Open Air”. Në malin e Moravës, organizohen fluturime të lira të aeronautistëve nga vënde të ndryshme të botës. Për të gjithë të apasionuarit pas sporteve në natyrë, do të zhvillohen fluturime të lira me ndihmën e profesionistëve. Pas përfundimit të aktivitetit, realizohet Ceremonia Zyrtare e ndarjes së çmimeve për fituesit e e “Korca Open Air 2020”

**Qëllimi:** Një risi e re dhe gjallërim i jetës përmes realizimit të sporteve ekstreme në qytetin e Korçës

### **Objektiva:**

- Promovimi i Korçës nga një tjetër këndvështrim nga sporti i aventurës
- Pjesëmarrja e shteteve të huaja në kampionat
- 3 ditë të mbushura me spektakël dhe adrenalinë të cilat i japin veçanti qytetit
- Pjesë e kalendarit kulturor dhe artistik ku bëhen bashkë me atë sportiv në periudhën me të bukur të festave të fundvitit.



## BASHKIA KORÇË

- Synimi është kthimi i këtij aktiviteti në një tradite kulturore
- Promovimi i qytetit në shtete të ndryshme
- Rritja e numrit të vizitorëve vendas dhe të huaj të apasionuar pas turizimit të aventurës në vitet në vazhdim

### **Përfituesit/ Treguesit**

- Mbi 300 pjesmarrës në festë gjatë 3 ditëve të organizimit të saj
- Vizitorët vendas dhe të huaj të apasionuar pas sporteve të aventurës
- Bizneset lokale ( Hotel/bujtina/ bare/ restorante) që përfitojnë direkt në rritjen e ekonomisë

### **Programi i Aktiviteteve:**

- Hartimi i kalendarit të eventeve të fundvitit
- Ngritja e grupit të punës
- Kontakte të përhershme me grupin e Aeronautikës
- Ndjekja e procedurave për akomodimin e grupit të aeronautikës
- Njoftim i qytetarëve që duan të bëhen pjesë e aktivitetit
- Promovim në media dhe në rrjetet sociale
- Realizim tre ditor i aktivitetit

### **Risia dhe Qëndrueshmëria e projektit:**

Korca open air organizohet për të disatin vit radhazi duke shënuar rritje të numrit të pjesmarrësve në aktivitet si dhe rritje të numrit të vizitorëve.

### **Rezultate:**

- Realizimi i fluturimeve të lira nga ajri për të gjithë qytetarët, vizitorët vendas dhe të huaj.
- Nxitja e brezit të rinj për të frekuentuar aktivitetet që zhvillohen në natyrë.
- Promovimi i qytetit dhe turizmit të aventurës nëpërmjet aktiviteteve

**Kostoja Totale: 360,000 Lekë**

**Institucioni Zbatues: Bashkia Korçë**

### **Struktura Përgjegjëse:**

Fondi i planifikuar në tranfertat tek organizatat për vitin 2020 është në vlerën 64,912 mijë lekësh e detajuar si më poshtë:

000/lekë

Programi	Institucioni	Përshkrimi i shpenzimeve operative	PI 2019	Real 10 mujor	%	PI e real të pritsh 2019	PI 2020	Dif PI 20-PI 19	Dif PI20-PI p 19



## BASHKIA KORÇË

Sport dhe argëtim	Bashkia	Transferte per kompleksin multif sportkulturo	12,000	8,740	73%	10,000	(12,000)	(10,000)
Sport dhe argëtim	Bashkia	Kontributi I Bashkise Korce per Qendren Sportive Korce					32,182	32,182
Sport dhe argëtim	Bashkia	Transferte per mirembajtjen dhe ruajtjen e terreneve sportive	17,000		0%	7,000	(17,000)	(7,000)
Sport dhe argëtim	Bashkia	Transferte per shlyerjen e detyrimeve ngdaj OSHEE	3,500	3,500	100%	3,500	(3,500)	(3,500)
Sport dhe argëtim	Bashkia	Kontributi i bashkise per futbollin	24,000	3,878	16%	10,000	32,730	8,730
<b>Total 604</b>			<b>56,500</b>	<b>16,118</b>	<b>29%</b>	<b>30,500</b>	<b>64,912</b>	<b>8,412</b>

Arsimi bazë dhe parashkollor 091

### 7.19. Programi: Arsimi bazë dhe parashkollor 09120

**Burimi i financimit: Transferta e pakushtëzuar dhe të ardhurat nga taksat dhe tarifatat vendore**

#### Njësia shpenzuese Bashkia

Mbështetja e arsimit bazë dhe parashkollor. Administrim dhe rregullim i sistemit arsimor parashkollor në kopshte dhe çerdhe.

Buxheti i këtij program është në vlerën 36,201 mijë lekë e detajuar si më poshtë:

- shpenzime korrente në vlerën 700 mijë lekë
- Shpenzime kapitale në vlerën 35,501 mijë lekë

Në shpenzimet korrente janë përfshirë:

700 mijë lekë fond i planifikuar për shpenzimet e Shkollës së Maltës, të detajuara si më poshtë:

**000/lekë**

Programi	Institucioni	Përshkrimi i shpenzimeve operative	Pl 2019	Real 10 mujor	%	Pl e real të pritsh 2019	Pl 2020	Dif Pl 20-Pl 19	Dif Pl20-Pl p 19
Arsimi bazë dhe parashkollor	Bashkia	Shpenz. karburanti për shkollën e Maltës	300	101	34%	300	300	0	0
Arsimi bazë dhe parashkollor	Bashkia	Shp. energji, ujë, telefon për shkollën e Maltës	400	312	78%	400	400	0	0
Arsimi bazë dhe parashkollor	Bashkia	Shpenzime qeramarje ambjenti	1,296	439	34%	900		-1296	-900



## BASHKIA KORÇË

Arsimi bazë dhe parashkollor	Bashkia	Shpenzime energji dhe ujë	480	134	28%	300		-480	-300
<b>TOTAL</b>			<b>2,476</b>	<b>986</b>	<b>40%</b>	<b>1,900</b>	<b>700</b>	<b>(1,776)</b>	<b>(1,200)</b>

Arsimi i mesëm i përgjithshëm 092

### 7.20. Programi: Arsimi I mesëm I përgjithshëm 09230

**Burimi i financimit: Transferta e pakushtëzuar dhe të ardhurat nga taksat dhe tarifrat vendore**

#### Njësia shpenzuese Bashkia

Ky program ka në fokus zhvillimin e projekteve për të rinjtë.

Buxheti i këtij program është në vlerën 215 mijë lekë e detajuar si më poshtë:

- shpenzime korrente në vlerën 215 mijë lekë

Këto shpenzime në vlerën 215 mijë lekë do të përdoren për realizimin e projekteve të reja të detajuara si më poshtë:

Programi	Institucioni	Përshkrimi i shpenzimeve operative	Pl 2019	Real 10 mujor	%	Pl e real 2019	PL 2020	Dif 20-19	Dif 20-Pl p 19
Arsim I mesem I pergjithshem	Bashkia	Sherbime te printimit & publikimit					16	16	16
Arsim I mesem I pergjithshem	Bashkia	Shpenzime te tjera					25	25	25
Arsim I mesem I pergjithshem	Bashkia	Shpenzime udhetim i brendshem					50	50	50
Arsim I mesem I pergjithshem	Bashkia	Shpenzime honorare					100	100	100
Arsim I mesem I pergjithshem	Bashkia	Shpenzime transporti					24	24	24
<b>TOTAL</b>							<b>215</b>	<b>215</b>	<b>215</b>

Projektet jepen të detajuara si më poshtë:

**Titulli i Projektit: Konferencë rinore “Zëri i qytetit tim”**

**Kohëzgjatja: 3 muaj**

**Përshkrim i shkurtër i projektit:**

Në kuadrin e rritjes së numrit të të rinjve në vendimmarrje si dhe në zgjidhjen e problematikave apo sjelljen e risive në qytetin e Korçës do të organizohet një Konferencë rinore me pjesëmarrjen e studentëve të universitetit Fan Noli, të rinjve të qendrave rinore Korçë, Vlorë dhe Tiranë si dhe do të ftohen të jenë pjesëmarrës dhe OJF që operojnë në fushën e rinisë në Korçë. Në këtë konferencë do



## BASHKIA KORÇË

të trajtohen jo vetëm çështje të rinisë por edhe problematika apo ide inovative që kanë të bëjnë me zhvillimin e qytetit.

### **Qëllimi:**

Angazhimi i të rinjve në mënyrë aktive në zhvillimin e qytetit të Korcës si dhe shkëmbim eksperience duke evidentuar praktikat më të mira.

### **Objektiva:**

- Zhvillimi i mendimit kritik tek të rinjtë
- Rritja e përfaqësimit efektiv të të rinjve në vendimmarje
- Prezantimi i gjetjeve dhe problematikave duke dhënë zgjidhje efektive dhe inovatore nga vetë të rinjtë
- Promovimi i qytetit si dhe shkëmbim eksperiencash mes tyre

### **Përfituesit/ Treguesit**

- 300 të rinj ( femra dhe meshkuj) do të jenë pjesë e konferencës për të shkëmbyer ide inovatore për zhvillimin e qytetit
- Institucioni i Bashkisë duke njohur problematikat dhe zgjidhjet e tyre me syrin e të rinjve

### **Programi i Aktiviteteve:**

- Ngritja e grupit të punës
- Evidentimi dhe krijimi i një database me të rinjtë
- Kontakte me OJF që operojnë në këtë fushë
- Draftimi i axhendës dhe selektimi i folësave
- Sigurimi i infrastrukturës së nevojshme (zhvillimi dhe printimi i banerit, fillimi i procedurave për akomodim të personave që do të vijnë nga Vlora dhe Tirana, si dhe procedurat tenderike për transportin për në Voskopojë ku do të njohen nga afër me investimet e kryera në një nga fshatrat më të rëndësishme turistike)
- Zhvillimi aktivitetit



## BASHKIA KORÇË

### **Risia dhe Qëndrueshmëria e projektit:**

Ky aktivitet zhvillohet për herë të parë dhe në fokus të saj janë të rinjtë. Vendosija e të rinjve në qendër të vendimmarrjes dhe zgjidhjes së problematikave

### **Rezultate:**

- Krijimi i aktivitetit me sukses dhe vendosja e themeleve për ta bërë një aktivitet të përvitshëm me rezultate konkrete
- Hartimi i një draft plani më sygjerime dhe zgjidhje për problematika të ndryshme që hasen në Bashkinë e Korçës

**Kostoja Totale: 82.000 Lekë**

**Institucioni Zbatues: Bashkia Korçë**

**Struktura Përgjegjëse: Njësia e Integritimit Evropian**

### **Titulli i Projektit: Konferenca Rinore**

**Kohëzgjatja: 1 ditë**

### **Përshkrim i shkurtër i projektit:**

Në kuadrin e ditës së Evropës e cila celebron në çdo datë 9 maj me nxënës të shkollave publike do të organizohet një aktivitet sensibilizues me materiale të perzgjedhura nga vetë nxënësit për të treguar mënyrën e krijimit, arsyet, zhvillimin dhe ecurinë e Bashkimit Evropian.

Ky aktivitet do të zhvillohet në një ambient të mbyllur me rreth 500 pjesëmarrës dhe do të vazhdojë rreth një orë. Pjesëmarrësit do të kenë mundësi të njihen më mënyrën e krijimit, arsyet, zhvillimin dhe ecurinë e Bashkimit Evropian nëpërmjet krijimeve dhe materialeve të sjella nga vetë nxënësit.

### **Qëllimi:**

Organizimi i një aktiviteti sensibilizues për të ndërgjegjësuar brezin e ri me aktivitet me fokus Bashkimin Evropian

### **Objektiva:**

- Evidentimi i talenteve të të rinjve në fusha të ndryshme artistike
- Pjesëmarrje aktive në aktivitete që lidhen me Bashkimin Evropian
- Ndërgjegjësim i tyre si qytetarë të ardhshëm të Bashkimit Evropian

### **Programi i Aktiviteteve:**

- Ngritja e grupit të punës



## BASHKIA KORÇË

- Krijimi i banerit reklamues i cili do të vendoset jashtë ambjeteve ku do të zhvillohet aktiviteti
- Nisja dhe finalizimi i procedurave për kontraktimin e personave që do të udhëheqin dhe do të merren me organizimin dhe rregullimin e aktivitetit.
- Zhvillimi i aktivitetit

### **Risia dhe Qëndrueshmëria e projektit:**

Ky aktivitet përkon me një ditë ndërkombëtare e cila festohet në të gjitha vendet Evropiane dhe si e tillë ky projekt do të ketë një qëndrueshmëri të gjatë. Nga viti në vit duke u bazuar tek eksperiencat do të përmirësohet duke iu përshtatur dhe tematikave të caktuara.

Bashkia e Korçës e ka të planifikuar për herë të parë këtë aktivitet duke marrë shkas dhe nga ngitja dhe funksionimi i Njesisë së Intergimit pranë kësaj bashkie.

### **Rezultate:**

- Krijimi i aktivitetit me sukses
- Përfshirja e 30 nxënësve në organizimin e këtij aktiviteti.
- Përcjella e mesazhit tek rreth 400 nxënës të tjerë dhe shkëmbim praktike me shkolla të tjera të qytetit
- Angazhimi i nxënësve në gjetjen e materialeve dhe zgjerimi i njohurive të tyre në këtë drejtim.

**Kostoja Totale: 133.000 Lekë**

**Institucioni Zbatues: Bashkia Korçë**

**Struktura Përgjegjëse: Njësia e Integritimit Evropian**

Të moshuarit 102

### **7.21. Programi: Sigurimi shoqëror 10220**

**Burimi i financimit: Transferta e pakushtëzuar dhe të ardhurat nga taksat dhe tarifatat vendore**

**Njësia shpenzuese: Bashkia**

Ky program përfshin administrimin dhe mirëmbajtjen e qendrave rezidenciale për të moshuarit.

Buxheti i këtij program është në vlerën 4,600 mijë lekë e detajuar si më poshtë:

- shpenzime korrente në vlerën 4,600 mijë lekë



## BASHKIA KORÇË

Fondi i planifikuar për shpenzime operative është në vlerën 4,600 mijë lekë, ku përfshihet kontributi për qendrën e Kujdesit Paliativ “Mary Potter” në vlerën 1,800 mijë lekë dhe pjesa tjetër janë shpenzime për realizimin e projektve dhe shpenzime operative për këtë program si më poshtë:

000/lekë

Përshkrimi i shpenzimeve operative	Pl 2019	Real 10 mujor	%	Pl e real të pritsh 2019	Pl 2020	Dif Pl20-Pl19	Dif Pl20-Pl p 19
Abonim internet ADSL dhe Central Telefonik	52		0%	52	50	(2)	(2)
Shpenzime karburanti per Q.K.P. M.Poter	1,240	336	27%	1,240	1480	240	240
Shpenzime kancelarie per Q.K.P. M.Poter	80	80	100%	80		(80)	(80)
Energji elektrike per Q.K.P. M.Poter	160	79	49%	160	130	(30)	(30)
Pagesa per ujin per Q.K.P. M.Poter	80	61	76%	80	80	-	-
Shpenz. telefon internet per Q.K.P. M.Poter	40	29	73%	40	45	5	5
Leter shkrimi fotokopimi Kancelari Q.K.P. M.Poter	60	60	100%	60	35	(25)	(25)
Boje printeri e fotokopjues Q.K.P. M.Poter					30	30	30
Sherbime te printimit & publikimit	188		0%	70	188	-	118
Shpenzime pritje-percjellje	78	68	87%	78	78	-	-
Shpenzime qeramarje ambjenti	1,584	812	51%	1,584	1584	-	-
Shpenzime te tjera	100		0%	100		(100)	(100)
Shpenzime energji dhe uje	900	482	54%	900	900	-	-
	<b>4,562</b>	<b>2,007</b>	<b>44%</b>	<b>4,444</b>	<b>4,600</b>	<b>38</b>	<b>156</b>

### Detajimi i projekteve:

**Titulli i Projektit:** “Karta për pensionistët”

**Kohëzgjatja:** Janar 2020

### Përshkrim i përgjithshem i projektit:

Të moshuarit pajisen me karta pensionisti, të cilat janë të personalizuar. Me to ata marrin disa shërbime falas dhe me çmim të reduktuar.

**Qëllimi:** Ky projekt ka për qëllim krijimin e një sistemi shërbimesh falas apo me çmime të reduktuara në fusha me interes për të gjithë pensionistet e qytetit të Korcës.



## BASHKIA KORÇË

**Rezultatet:** 5000 pensionistë do të përfitojnë lehtësira në shërbimin e transportit si dhe në aspektin financiar

**Objektivat:** Çdo pensionist përfiton:

- falas shërbimin e transportit urban,
- ndjekjen e ndeshjeve në stadium dhe në pallatin e sportit, ulje të çmimit të biletës në teatër në masën 50% si dhe ulje në masën 20%- 50% në disa shërbime si në njësi tregtimi, apo shërbimesh të nevojshme për moshën e tretë.
- disa shërbime e analiza mjekësore falas nga klinika në qytetin tonë.

**Vlerat e projektit:** Projekti synon të rritë mirëqënien e të moshuarve, duke i lehtësuar nga disa shpenzime shërbimesh të përditshme, me synim rritjen e cilësisë së jetesës së tyre.

**Kosto buxheti Bashkia:** 187.500 lekë

**Titulli i Projektit :** “Qendra Komunitare për moshën e tretë” 2020

**Kohëzgjatja:** 12 muaj

**Përshkrim i përgjithshëm i projektit:**

**Qëllimi:** Krijimi i kushteve të përshtatshme dhe ofrimi i shërbimeve psiko-sociale, mjekësore, kulturore e argëtuese për të moshuarit me qëllim zbutjen e problemeve të moshës së tretë dhe shmangies e izolimit social të tyre.

**Objektivat:** Krijimi i kushteve të përshtatshme dhe ofrimi i shërbimeve psiko-sociale, mjekësore, kulturore e argëtuese për të moshuarit me qëllim zbutjen e problemeve të moshës së tretë dhe shmangies e izolimit social të tyre.

Objektiva 1: Ofrimi i një mjedisi çlodhës dhe mikëpritës për të moshuarit.

Objektiva 2: Ofrimi i shërbimeve të specializuara sociale nëpërmjet 3 kujdestarëve të qendrave, punonjësit sociale dhe atij animator.

Objektiva 3: Organizimi i aktiviteteve social-kulturore, argëtuese

Objektiva 4: Përmirësimi i kushteve shëndetsore të frekuentuesve të Qendrave

Objektiva 5: Ofrimi i shërbimeve të tjera të nevojshme për të moshuarit.



## BASHKIA KORÇË

**Rezultatet:** Krijimi i një ambjenti sa më mikëpritës në Qendrat Komunitare. Zvogëlimi i fenomenit të braktisjes dhe vetmisë të Moshës së Tretë. Vazhdimësia e përmirësimit të shërbimeve sociale në qytetin e Korcës.

**Vlera e projektit:** Qendrat ditore për moshën e tretë përmirësojnë jetën sociale të këtij target grupi, duke rritur kështu edhe cilësinë e jetës së tyre të përditshme.

**Kosto buxheti Bashkia:** 2,484,000 lekë

**Titulli i projektit:** Dita ndërkombëtare e moshës së tretë

**Kohëzgjatja:** Shtator- 1 Tetor 2020

**Përshkrim i shkurtër i projektit:** Moshë e tretë është moshë e cila ka më tepër nevojë për përkujdesje dhe mbështetje. Me qëllim sensibilizimin e shoqërisë për të drejtuar vëmendjen ndaj kësaj shtrese në nevojë, Bashkia Korçë ka organizuar një sërë aktivitetesh me qendrat e moshës së tretë dhe me personat e moshës së tretë të vetmuar.

**Qëllimi:** Mbështetja dhe kujdesi ndaj moshës së tretë, për të transmetuar dhe edukuar tek brezat e rinj përkujdesjen që duhet të tregojnë ndaj këtyre personave.

**Objektiva:**

1. Vlerësimi i rolit të të moshuarve në shoqëri
2. Përfshirja e të moshuarve në jetën shoqërore
3. Përkujdesi dhe respekti për personat e moshës së tretë.

### **Përfituesit/ Treguesit**

- 52 persona të moshës së tretë të vetmuar

### **Programi i Aktiviteteve:**

1. Përcaktimi dhe verifikimi i listës së personave të moshuar të vetmuar në Bashkinë Korçë.
2. Kontakti me shkollat e qytetit për pjesëmarrjen në aktivitet duke ofruar një program artistik në lidhje me këtë ditë.
3. Përgatitja dhe përzgjedhja e vendit të përshtatshëm për realizimin e projektit. Duke qenë se personat janë në moshë të thyer, duhet siguruar një ambient i pozicionuar në qendër të qytetit, lehtësisht i aksesueshëm nga kjo kategori personash, të cilët do të marrin pjesë në aktivitet.
4. Realizimi i aktivitetit në datën 1 Tetor 2020



## BASHKIA KORÇË

5. Përgatitja e materialeve që do të dhurohen (shah, domino, etj)

6. Përgatitja dhe dorëzimi i dokumentacionit përmbyllës për realizimin e projektit (relacion, foto).

**Risia dhe Qëndrueshmëria e projektit:** Projekti këtë vit zbatohet për herë të tretë pas suksesit të implementimit të tij në dy vitet e kaluara. Duke qenë se numri i të moshuarve dhe nevojat e tyre për përkujdesje janë në rritje, projekti do të vijojë të zbatohet edhe në të ardhmen, duke pasur parasysh kërkesat e personave të moshës së tretë dhe duke ofruar mundësi për plotësimin e tyre.

**Rezultatet:** Nëpërmjet këtyre projekteve, sensibilizojmë shoqërinë dhe të rinjtë të drejtojnë vëmendjen ndaj kësaj shtrese, në mënyrë që t'ju lehtësojnë atyre sadopak problemet e moshës.

**Kostoja Totale: 78.000 Lekë**

**Institucioni Zbatues:** Bashkia Korçë

**Struktura Përgjegjëse:** Drejtoria e Projekteve, Integritimit Europian, Koordinimit me Donatorët dhe Turizmit

/lekë

Emertimi i Projektit	Programi	Sherbime	Shp qeramarrje	Shpenzime	Shp te tjera	TOTALI
		te print & publikimit	Qira ambjenti	energji & uje	sh.operativ	
		6022010	6026100	6022001-002	6029099	
Karta per pensionistët	Sigurimi shoqeror	187,500				187,500
Dita nderkombetare e moshes se trete	Sigurimi shoqeror				78,000	78,000
Qender komunitare per moshen e trete	Sigurimi shoqeror		1,584,000	900,000		2,484,000
<b>Total prog Sigurimi Shoqeror</b>		<b>187,500</b>	<b>1,584,000</b>	<b>900,000</b>	<b>78,000</b>	<b>2,749,500</b>

Sëmundje dhe paaftësi 101

### 7.22. Programi: Kujdesi social për personat e sëmurë dhe me aftësi të kufizuara 10140

**Burimi i financimit:** Transferta e pakushtëzuar dhe të ardhurat nga taksat dhe tarifatat vendore

**Njësia shpenzuese:** Bashkia



## BASHKIA KORÇË

Ky program përfshin krijimin dhe administrimin e shërbimeve sociale, në nivel vendor, për shtresat në nevojë, personat me aftësi të kufizuara, fëmijët, gratë, gratë kryefamiljare, gratë e dhunuara, viktimat të trafikut, nëna apo prindër me shumë fëmijë, të moshuarit etj., sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.

Buxheti i këtij program është në vlerën 12,319 mijë lekë dhe nr I punonjësve është 18, i detajuar si më poshtë:

- shpenzime personeli në vlerën 11,950 mijë lekë
- shpenzime korrente në vlerën 369 mijë lekë

Fondi i planifikuar për paga është në vlerën 10,240 mijë lekë.

Fondi i planifikuar për sigurime shoqërore dhe shëndetësore është në vlerën 1,710 mijë lekë.

Fondi i planifikuar për shpenzime operative është në vlerën 369 mijë lekë, të cilat do të përdoren për realizimin e projekteve, si më poshtë:

000/lekë

Përshkrimi i shpenzimeve operative	PI 2019	Real 10 mujor	%	PI e real të pritsh 2019	PI 2020	Dif PI20-PI 19	Dif PI20-PI p 19
Sherbime te printimit & publikimit	89		0%	89	99	10	10
Shpenzime pritje-percjellje	75		0%	75	198	123	123
Festa e 8 marsit	27	27	100%	27		(27)	(27)
Shpenzime te tjera	12		0%	12	72	60	60
<b>Total</b>	<b>203</b>	<b>27</b>	<b>13%</b>	<b>203</b>	<b>369</b>	<b>166</b>	<b>166</b>

Detajimi i projekteve:

Emërtimi i projektit	Programi	Shërbime të printimit dhe publikimit	Shpenzime pritje-percjellje	Shpenzime dekori	Shpenzime të tjera operative	Totali
Dita nderkombetare e PAK	Kujdesi social per personat e semure dhe me aftesi te kufizuara		97,500		11,620	109,120



## BASHKIA KORÇË

Dita ndërkombëtare e shkopit të bardhë	Kujdesi social per personat e semure dhe me aftesi te kufizuara				100,000	100,000
Dita e autizmit	Kujdesi social per personat e semure dhe me aftesi te kufizuara	99,000		60,000		159,000
<b>Total prog Kujdesi soc per PAK</b>		<b>99,000</b>	<b>97,500</b>	<b>60,000</b>	<b>111,620</b>	<b>368,120</b>

### Titulli i projektit: Dita e autizmit

#### Përshkrimi i shkurtër:

Me rastin e 2 Prillit, Ditës Ndërkombëtare të Autizmit, Bashkia Korçë do të organizojë një aktivitet sensibilizues me qëllim sensibilizimin e shoqërisë për të mirëpritur këtë shtresë në nevojë.

**Qëllimi:** Nëpërmjet shpërndarjes së fletëpalosjeve dhe kartolinave me mesazhe që kanë lidhje me këtë ditë ndërkombëtare, të sensibilizojmë shoqërinë për t'i mirëpritur dhe për të mbështetur këtë shtresë në nevojë.

#### Përfituesit/ Treguesit

- 50 fëmijë autikë të cilët përfitojnë mbështetje sociale nga Bashkia Korçë

#### Objektivat:

- 1- Ndihmojmë fëmijët me aftësi ndryshe përmes mbledhjes së të ardhurave nga shitja e luleve në qytet.
- 2- Njohja me problematikat e fëmijëve me aftësi ndryshe përmes shpërndarjes së fletëpalosjeve për qytetarët.

**Rezultatet:** Nëpërmjet aktiviteteve sensibilizuese, shoqëria njihet nga afër me problematikat e fëmijëve me aftësi ndryshe, duke u angazhuar gjithnjë e më tepër në mbështetje dhe ndihmesë të tyre.

**Vlera e projektit:** 159.000 Lekë

Titulli i projektit: Dita e shkopit të bardhë.



## BASHKIA KORÇË

**Kohëzgjatja:** 1- 15 Tetor 2020

**Përshkrim i shkurtër i projektit:** Bashkia Korçë ka treguar vazhdimisht një kujdes të veçantë për personat me aftësi të kufizuar shikimi, duke i ndihmuar vazhdimisht me materiale të cilat lehtësojnë përfshirjen në jetën e përditshme shoqërore. Gjithashtu, nga viti në vit përmes projekteve të ndryshme sociale, Bashkia Korçë ka bërë të mundur rritjen e ndërgjegjësimit të shoqërisë për të mirëpritur këtë shtresë në nevojë.

**Qëllimi:** Nëpërmjet takimeve të organizuara me këtë shtresë në nevojë, kuptojmë më mirë problematikat dhe përpiqemi t'i minimizojmë ato përmes zbatimit të projekteve të ndryshme.

### **Objektiva:**

- Krijimi i tryezave të rumbullakëta, ku diskutohen gjithë problematikat që shqetësojnë personat me aftësi të kufizuar shikimi.
- Realizimi i projekteve të ndryshme, që do të ndikojnë drejtpërdrejt në zgjidhjen e problematikave të kësaj shtrese në nevojë.

### **Përfituesit/ Treguesit**

- 50 persona me aftësi të kufizuar shikimi

### **Programi i Aktiviteteve:**

- Kontakti me të gjitha OJF-të dhe institucionet që kanë për fokus të punës së tyre këta persona.
- Realizimi i tryezës së rumbullakët, bashkëbisedim midis Shoqatës së PAK dhe institucioneve pjesëmarrëseve.
- Përgatitja e materialeve që do t'iu dhurohen (shkopinj të bardhë për personat e verbër)
- Përgatitja e dokumentacionit përmbyllës (relacion, foto)

**Risia dhe Qëndrueshmëria e projektit:** Takimet mes institucioneve të ndryshme dhe Shoqatës së PAK duhet të organizohen në vazhdimësi me qëllim njohjen dhe ndërmarrjen e masave për zgjidhjen e problematikave të kësaj shtrese në nevojë.

**Rezultatet:** Integrimi i personave me aftësi të kufizuar shikimi në jetën shoqërore.

**Kostoja Totale: 100.000 Lekë**

**Institucioni Zbatues:** Bashkia Korçë

**Struktura Përgjegjëse:** Drejtoria e Projekteve, Integritit European, Koordinimit me Donatorët dhe Turizmit



## BASHKIA KORÇË

### **Titulli i projektit: Dita Ndërkombëtare e Personave me Aftësi të Kufizuar 3 Dhjetori**

**Përshkrim i shkurtër i projektit:** Me rastin e 3 Dhjetorit Ditës Ndërkombëtare të Personave me Aftësi të Kufizuar, Bashkia Korçë ka organizuar çdo vit aktivitete të ndryshme kulturore e sportive, në mënyrë që të rritë ndërgjegjësimin e shoqërisë për të lehtësuar gjithëpërfshirjen e tyre në jetën shoqërore.

**Qëllimi:** Rritja e ndërgjegjësimit të qytetarëve për t'ju ardhur në ndihmë kësaj shtresës në nevojë.

**Objektiva:** Gjithëpërfshirja e PAK në aktivitetet kulturore dhe në jetën e përditshme.

#### **Përfituesit/ Treguesit**

- 150 persona me aftësi të kufizuar, të cilët bëhen pjesë në aktivitetet

#### **Programi i Aktiviteteve:**

1. Komunikimi me institucionet që punojnë me personat me aftësi të kufizuar.
2. Përzgjedhja e vendit për organizimin e koktejit për pjesëmarrësit.
3. Realizimi i ekspozitës me punimet e artistike të realizuara nga personat me aftësi ndryshe.
4. Realizimi i materialeve promocionale (ftesa për donatorët, fletëpalosje për lajmërim të qytetarëve)
5. Realizimi i aktivitetit në datën 3 Dhjetor.
6. Përgatitja e dokumentacionit përmbyllës (relacion, foto).

**Risia dhe Qëndrueshmëria e projektit:** Ndryshe nga vitet e kaluara, këtë vit në aktivitet do të ftohen psikologë dhe mësues ndihmës të shkollave të Bashkisë Korçë.

**Rezultatet:** - Sensibilizimi i popullsisë për të mirëpritur PAK në jetën e përditshme.

- Duke dëgjuar zërin e PAK do të mund të gjejnë zgjidhje sa më shumë pengesat që dalin përpara në rrugën e gjithëpërfshirjes.

**Kostoja Totale: 109.120 Lekë**

**Institucioni Zbatues:** Bashkia Korçë

**Struktura Përgjegjëse:** Drejtoria e Projekteve, Integritet Europian, Koordinimit me Donatorët dhe Turizmit

Familje dhe fëmijët 104

### **7.23. Programi: Kujdesi social për familjet dhe fëmijët 10430**

**Burimi i financimit:** Transferta e pakushtëzuar dhe të ardhurat nga taksat dhe tarifatat vendore

**Njësia shpenzuese:** Bashkia



## BASHKIA KORÇË

Ky program përfshin përfitimet në para apo pagesa të tjera periodike apo të njëhershme për të mbështetur familjet ose për t'i ndihmuar ato të përballojnë kostot e nevojave specifike (për shembull, familjet me një prind të vetëm ose familjet me fëmijë të paaftë). Mbështetje të pjesshme për faturën e energjisë elektrike dhe konsumin e ujit dhe shërbimet sanitare.

Buxheti i këtij program është në vlerën 6,438 mijë lekë dhe nr. i punonjësve është 3. E detajuar si më poshtë:

- shpenzime personeli në vlerën 2,224 mijë lekë
- shpenzime korrente në vlerën 3,414 mijë lekë

Fondi i planifikuar për paga është në vlerën 1,905 mijë lekë, krahasuar me vitin 2019 ka një rritje prej 632 mijë lekësh .

Fondi i planifikuar për sigurime shoqërore dhe shëndetësore është në vlerën 319 mijë lekë, krahasuar me vitin 2019 ka një rritje prej 106 mijë lekësh .

Fondi i planifikuar për shpenzime operative është në vlerën 3,414 mijë lekë, krahasuar me vitin 2019 ka një rritje prej 771 mijë lekësh, nga të cilat 2,346 mijë do të përdoren për realizimin e projekteve në këtë program si më poshtë:

000/lekë

Përshkrimi i shpenzimeve operative	PI 2019	Real 10 mujor	%	PI e real të pritsh 2019	PI 2020	Dif PI20-PI19	Dif PI20-PI p 19
Shërbime postare	195	195	100%	195	41	(154)	(154)
Abonim internet ADSL dhe Central Telefonik	52		0%	52	50	(2)	(2)
Energjia elektrike Bashki	828	819	99%	628	764	(64)	136
Pagese e konsumit të ujit	78	78	100%	78	108	30	30
Udhetime Brenda dhe jashtë (dieta)	350		0%	300		(350)	(300)
Leter shkrimi fotokopimi Kancelari	15	15	100%	15	15	-	-
Boje printeri e fotokopjues	50	50	100%	50	89	39	39
Blloqe administrative letra me vlere	300		0%	300		(300)	(300)
Fond per invalidin e luftes r. lalaj	150	150	100%	150		(150)	(150)
Sherbime te printimit & publikimit	110		0%	110	133	23	23



## BASHKIA KORÇË

Shpenzime qeramarje ambjenti	108	54	50%	108	1404	1,296	1,296
Shpenzime te tjera	227	159	70%	227	150	(77)	(77)
Shpenzime energji dhe uje	180	4	2%	180	660	480	480
<b>Total</b>	<b>2,643</b>	<b>1,524</b>	<b>58%</b>	<b>2,393</b>	<b>3,414</b>	<b>771</b>	<b>1,021</b>

Detajimi i projekteve:

Emertimi i Projektit	Programi	Sherbime	Shp qeramarrje	Shpenzime	Shp te tjera	TOTALI
		te print & publikimit	Qira ambjenti	energji & uje	sh.operativ	
		6022010	6026100	6022001-002	6029099	
Strehëza emergjente për rastet e dhunës në familje	Kujdesi social per Familjet dhe femijet		108,000	180,000		288,000
Dita nderkombetare e gruas 8 mars	Kujdesi social per Familjet dhe femijet	132,400			13,000	145,400
Ndërgjegjësimi i komunitetit në zonat rurale nËj aktiviteteve sensibilizuese në luftën kundër dhunës në familje	Kujdesi social per Familjet dhe femijet				136,900	136,900
Qendra ditore per femije	Kujdesi social per Familjet dhe femijet		1,296,000	480,000		1,776,000
<b>Total prog Kujdesi soc per familje dhe femije</b>		<b>132,400</b>	<b>1,404,000</b>	<b>660,000</b>	<b>149,900</b>	<b>2,346,300</b>

### Titulli i Projektit : “Strehëzë emergjente” 2020

**Kohëzgjatja: 12 muaj**

#### Përshkrim i përgjithshëm i projektit:

Marrja me qera e një apartamenti, pagesa e ujit dhe energjisë elektrike. Ky apartament shërben si strehëz për rastet emergjente të dhunës në familje. Në bashkëpunim me partnerët bëhet plotësimi i nevojave të tyre në veshmbathje dhe ushqim dhe shërbim psiko-social.

**Qëllimi:** Krijimi i një ambjenti familjar dhe të sigurt për viktimat e dhunës në familje në momentin emergjent që paraqitet.

#### Objektivat:

1. Marrja me qera e një apartamenti që do të shërbejë si strehëz emergjente.



## BASHKIA KORÇË

2. Akomodimi i personave të dhunuar deri në kalim e emergjencës që paraqet rasti.

3. Sigurimi i shërbimeve të tjera të nevojshme që do të mundësohen nga një organizatë jo qeveritare.

**Rezultatet:** Viktimat e dhunës në familje do të kenë një strehim të sigurt larg ambjentit të dhunshëm deri në momentin e akordimit të Urdhërit të Menjëhershëm të Mbrojtjes ose Urdhërit të Mbrojtjes nga Gjykata Rrethit Gjyqësor Korçë.

Gjatë qëndrimit në strehëz të mbijetuarat e dhunës dhe fëmijët e tyre do të marrin shërbim psiko-social dhe mbulimin e nevojave të tyre në veshmbathje, shtresa për fjetje, ushqim, ngrohje ambjenti, ujë të ngrohtë, produkte higjieno- sanitare, enë kuzhine, shtretër të vegjël për fëmijë, ushqim i veçantë për grup-moshën 0-3 vjeç. Përfituesit kanë mundësi edhe për zbavitje, si p.sh lodra për fëmijë, televizor, radio etj.

Përfituesit duhet të kujdesen vetë për pastrimin e ambjentit dhe gatimin nëse qëndrimi i tyre është për një afat më të gjatë se dy ditë, në rastin e Urdhërit të menjëhershëm të mbrojtjes dhe 20 ditë deri në akoordinimin e Urdhërit të mbrojtjes.

**Vlera e projektit:** Ky projekt ka shumë rëndësi në menaxhimin e rasteve të dhunës në familje . Strehimi i tyre është një shërbim bazë në uljen e rrezikut për viktimën e dhunës në familje, që mund të rrezikojnë edhe humbjen e jetës.

**Kosto buxheti Bashkia:** 288 000 lekë

**Titulli i Projektit:** Ndërgjegjësimi i komunitetit nëpërmjet aktiviteteve sensibilizuese në luftën kundër dhunës në familje.

**Kohëzgjatja:** Janar 2020 në vazhdimësi

### **Përshkrim i përgjithshëm i projektit:**

Në Njësitë Administrative nuk ka struktura të mirëngritura për menaxhimin e rasteve në territorin e tyre. Kjo bën që personat që janë viktimat të dhunës në familje, kryesisht gra dhe fëmijë, ta kenë të vështirë që të vetëm të dalin nga situata në të cilën ndodhen. Pranë këtyre njësive është e domosdoshme prania e një grupi multidisiplinar, i cili do të asistojë këta persona.

Ky projekt është projektuar për të përmirësuar shërbimet dhe për të forcuar mekanizmin e referimit të rasteve të dhunës në familje, jo vetëm në nivel të bashkisë, por edhe në nivel Njësie Administrative. Shumica e Njësive Administrative nuk ka ekip teknik të ngritur, por vetëm një person përgjegjës, i cili nuk e ka detyrë funksionale menaxhimin e rasteve të dhunës.

Popullata e Njësive Administrative duhet informuar, sepse ka mungesë informacioni. Menaxhimin e rastit pas referimit e bën Bashkia qendër.



## BASHKIA KORÇË

Megjithëse numri i denoncimeve është në rritje, përsëri, duhet kryer një sensibilizimin i popullsisë në zonat rurale, me komunitetin parashkollor dhe atë të shkollave me qëllim që të kontribuojmë në parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna në familje.

**Qëllimi:** Sensibilizimi i komunitetit mbi fenomenin e dhunës në familje

**Objektivat:** .

-Komuniteti i zonave rurale do të marrë informacion mbi fenomenin e dhunës në familje dhe pasojat negative që ai sjell.

-Do të marrë informacion të nevojshëm për mënyrën sesi mund të denoncohet dhuna.

- Do të informohet rreth shërbimeve që ofrohen dhe rëndësinë që ka denoncimi.

**Rezultatet:** Rritja e sensibilizimit të popullsisë në zonat rurale.

**Vlera e projektit:** Një aspekt shumë i rëndësishëm në luftimin e dhunës në familje është bërja e njohur e fenomenit dhe aspekteve negative të tij. Nga statistikat rezulton që komuniteti i zonave rurale, kryesisht gra dhe vajza, ndonëse të dhunuara, nuk raportojnë për dhunën e ushtruar. Sensibilizimi është mjaft i rëndësishëm në mënyrë që të rritet denoncimi ndaj krimit të dhunës në familje në këto zona.

**Kosto buxheti Bashkia:** 136.900 lekë

**Titulli i projektit:** Dita Ndërkombëtare e gruas

**Data :** 8 mars 2020

**Përshkrim i shkurtër i projektit:**

